

Albert Rakipi

SHQIPËRIA DHE KOSOVA
A ËSHTË BASHKIMI E
ARDHMJA E PËRBASHKËT?



Tiranë, 2020



Realizmi i këtij studimi u bë i mundur me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, në kuadër të projektit **“Shqipëria dhe Kosova: Cila është e ardhmja? Dekonstruktimi i idesë së bashkimit.”** Opinionet e shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet apo qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Albert Rakipi

Redaktor
Ledion Krisafi, PhD

Grafika
Daniel Prifti

ISBN
978-9928-195-30-2



Botues: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare
Rr. “Andon Zako Çajupi” Nr. 20/5, Tiranë
Tel: +355 444 00084 Fax: +355 444 00085
E-mail: aiis@aiis-albania.org
Website: www.aiis-albania.org

Albert Rakipi

Redaktor
Ledion Krisafi, PhD

Grafika
Daniel Prifti

ISBN
978-9928-195-30-2



Botues: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare
Rr. "Andon Zako Çajupi" Nr. 20/5, Tiranë
Tel: +355 444 00084 Fax: +355 444 00085
E-mail: aiis@aiis-albania.org
Website: www.aiis-albania.org

Përmbajtja

Hyrje	7
-------------	---

KAPITULLI I

SHQIPËRIA DHE KOSOVA: NJË VËSHTRIM HISTORIK.....	15
Kosova si komponent themelor i çështjes kombëtare shqiptare.....	16
1913-1990, në kërkim të vendit amë.....	20
Çështja e bashkimit pas Luftës së Ftohtë.....	26

KAPITULLI II

BASHKIMI I KOSOVËS ME SHQIPËRINË: PERCEPTIME DHE REALITETE.....	33
Mbështetje popullore për bashkimin: mirë se vini në botën mitike	35
Marrëdhënie të varfra, tensione në rritje	37
Bashkimi si dogmë dhe si realitet	46

KAPITULLI III

NJË BASHKIM EVENTUAL: CILAT JANË IMPLIKIMET?.....	59
Shqetësimet, kufizimet dhe pëlqimi nga fuqitë e mëdha	62
Implikime në mjedisin ndërkombëtar	68
Dilema e sigurisë në nivelin lokal.....	73

KAPITULLI IV

Përfundime	83
Bibliografi.....	95
Shtojca 1	103

Hyrje

Cfarë duhet bërë për t'i dhënë fund dramës së çështjes kombëtare shqiptare?¹ Kësaj pyetjeje, të shtruar nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, në platformën e saj të vitit 1998, për zgjidhjen e çështjes kombëtare, i është “përgjigjur” njëzet vjet më pas kryeministri i Shqipërisë dhe i është përgjigjur dy herë.

Së pari, më 18 Shkurt 2018, gjatë festimeve jubilarë për dhjetë vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Duke folur në seancën plenare të parlamentit të Kosovës, kryeministri Edi Rama propozoi zgjedhjen e një presidenti të përbashkët për Shqipërinë dhe Kosovën.² Propozimi krejtësisht i papritur e bëri edhe më solemne heshtjen në sallën e parlamentit të Kosovës, që ishte zbukuruar edhe me flamurin kombëtar kuq e zi, i cili zyrtarisht është flamuri shtetëror i Republikës së Shqipërisë. Habia e të 120 deputetëve të Republikës së Kosovës dhe gati e të gjithë “parisë” politike të Tiranës, gjithashtu e pranishme në sallën

solemne, sidomos përpjekja për ta fshehur këtë habi dhe tek tuk buzagazi ironik i të zgjedhurve të popullit nga të dyja anët e kufirit, dëshmonin se propozimi për një president të përbashkët Shqipëri-Kosovë ishte thjesht një ide e kryeministrit të Shqipërisë, e pa konsultuar as në Tiranë dhe as në Prishtinë.

Së dyti, më 26 nëntor 2018, gjatë mbledhjes së përbashkët të qeverive të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës në Pejë. Kryeministri i Shqipërisë, ftoi kryeministrin e Kosovës që të dy ministritë e Punëve të Jashtme të fillonin punën për *përgatitjen e një dokumenti strategjik për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën* në vitin 2025. I gjendur në befasi, Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, që ishte edhe mikpritësi i mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, pranoi para gazetarëve se kishin diskutuar edhe për “përgatitjen e një dokumenti analitik, strategjik, se si do të ecin deri në vitin 2025” dhe cila do të ishte perspektiva e shqiptarëve në Ballkan,³ por pa iu referuar bashkimit të dy shteteve të propozuar nga homologu i tij nga Republika e Shqipërisë.

Gjatë njëzet vjetëve të fundit këto janë dy propozimet e vetme, që vijnë nga institucionet shtetërore të Shqipërisë, pas Platformës së Akademisë së Shkencave të bërë publike më 1998. Në këtë platformë, që është identifikuar si *traktati* i nacionalizmit shqiptar për “të realizuar Shqipërinë e Madhe,” pyetjes se çfarë duhet bërë për të zgjidhur dramën e çështjes kombëtare shqiptare, Akademia e Shkencave i përgjigjet: E vetmja zgjidhje është ndërhyrja urgjente e Komunitetit Ndërkombëtar për ta detyruar Beogradin të njohë Republikën e Kosovës si një shtet të pavarur dhe... të hapur edhe ndaj Serbisë, edhe ndaj Shqipërisë.⁴

Njëzet vjet më parë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, përmes platformës për zgjidhjen e çështjes kombëtare, propo-

zonte si objektiv maksimal një Kosovë të pavarur nga Serbia, por të hapur edhe ndaj Shqipërisë, edhe ndaj Serbisë.

Po çfarë ka ndodhur që Shqipëria po i ikën këtij objektiv të përcaktuar nga Akademia e Shkencave? Përse njëzet vjet pas çlirimit të Kosovës nga Serbia dhe dhjetë vjet pas shpalljes dhe njohjes së Kosovës si shtet i pavarur, Shqipëria përmes dy propozimeve kërkon bashkimin e të dy shteteve? Çfarë ka ndodhur realisht në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës: A është *bashkimi* e ardhmja e përbashkët e të dy shteteve dhe a po përgatiten të dy shtetet për këtë *bashkim*?

Nga pikëpamja strategjike, Shqipëria dhe Kosova e shikojnë të ardhmen e tyre të përbashkët si anëtare të Bashkimit Europian. Gjatë gjashtë ose shtatë viteve të fundit, ideja e bashkimit të dy shteteve apo *e bashkimit kombëtar* duket të jetë gjithnjë e më e pranishme në narrativët politikë në Shqipëri dhe në një sërë iniciativash të ndërmarra kryesisht nga qeveria shqiptare.

Duke filluar nga viti 2014, Shqipëria dhe Kosova organizojnë mbledhje të përbashkëta të të dy qeverive, një nismë që u propozua nga Tirana.⁵ Asnjë nga marrëveshjet e shumta të nënshkruara në takimet e përbashkëta të të dy qeverive, përfshirë edhe marrëveshjen për partneritetin strategjik, nuk i referohet në mënyrë eksplicite çështjes së bashkimit të dy shteteve. Megjithëkëtë skenografia e mbledhjeve të përbashkëta plot ngjyra dhe simbole kombëtare, ku është e vështirë të dallosh simbollet shtetërore dhe sidomos fjalimet politike të udhëheqësve, që flasin gjithë ekuivoke *për kombin, të ardhmen e përbashkët dhe bashkimin*,⁶ si dhe raportimet që shkojnë te publiku *për bashkimin doganor, për heqjen e kufijve midis Shqipërisë dhe Kosovës*,⁷ po forcojnë gjithmonë e më shumë idenë se ardhmja e

Shqipërisë dhe Kosovës është bashkimi i tyre.

Paralel me sferën e marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Kosovës, duket se ka edhe një kontekst tjetër që ushqen narrativin e bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë apo *bashkimit kombëtar*: Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Europian dhe pikërisht *status-quo*-ja, nëse jo hapat mbrapa në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Teza se, përveç *bashkimit me Europën*, ekziston edhe mundësia e “bashkimit të shqiptarëve mes vedit” duket se po zë vend gjithmonë e më shumë në narrativët politikë në Shqipëri.⁸ Kur dy vjet më parë, nëntor 2018, kryeministri i Shqipërisë i kërkoi kryeministrit të Kosovës që të dy ministrinë e punëve të jashtme të fillonin përgatitjen e një strategjie për bashkimin deri në vitin 2025,⁹ argumenti kryesor për bashkimin e Shqipërisë dhe të Kosovës lidhej me mungesën e vullnetit të Bashkimit Europian për të vijuar procesin e integritit me Shqipërinë dhe Kosovën. Qëndrime të tilla tingëllojnë njëherazi edhe si hakmarrje, edhe si presion, nëse jo si shantazh për këtë mungesë vullneti.

Sido që të jetë, në vend po forcohet ideja se *bashkimi kombëtar* mund të jetë një alternativë ndaj integritit evropian të Shqipërisë: Në rast se “Europa i mbyll dyert për Shqipërinë,” atëherë zgjidhja mbetet bashkimi mbarëkombëtar, që nënkupton së pari bashkimin me Kosovën.

Përveç këtij konteksti, teza e domosdoshmërisë së *bashkimit* është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme dhe vijon të mbështetet në dy argumente të lidhura me njëri tjetrin. Së pari, argumenti historik: kombi shqiptar dhe territoret e tij janë ndarë padrejtësisht dhe *bashkimi kombëtar* do të zgjidhë një padrejtësi historike dhe përfundimisht do të zgjidhë çështjen kombëtare shqiptare.

Argumenti i dytë ka të bëjë me funksionalitetin e shtetit shqiptar. Arsyeja perse Shqipëria historikisht ka pasur dhe ka

një shtet të dobët, jo funksionues është “ndarja e kombit dhe copëtimi i territoreve të tij”. Nga bashkimi i të gjithë shqiptarëve dhe i të gjitha territoreve shqiptare do të përftohet një shtet funksional i fortë, konkurrues, do të sigurohet përparimi ekonomik dhe do të rritet prestigji dhe fuqia politike dhe diplomatike e Shqipërisë, si edhe do të fuqizohet kombi shqiptar.

Ndërkaq, në median ndërkombëtare po qarkullon edhe teza e bashkimit të Shqipërisë dhe Kosovës mbi baza fetare. Sipas kësaj teze, refuzimi i BE-së për të pranuar si anëtare Shqipërinë, një vend me shumicë myslimane, do ta inkurajojë këtë të bashkohet në një aks religjioz, islamik, me vende që kanë të njëjtën fe, duke filluar nga Kosova.¹⁰

Gjithsesi dhe pavarësisht nga motivet, fakti është se edhe përmes këtij konteksti çështja e bashkimit Shqipëri-Kosovë po bëhet gjithnjë e më popullore.

Historikisht, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë apo *zgjidhja e çështjes kombëtare* ka qenë një fushë ekskluzive e qarqeve nacionaliste/populiste, të cilat kanë qenë përgjithësisht periferike, të vendosura kryesisht në diasporën shqiptare në Perëndim dhe pa ndonjë influencë në shoqërinë shqiptare në Republikën e Shqipërisë. Gjatë pesë-gjashtë vjetëve të fundit, ndonëse me të njëjtën paqartësi, plot ekuivoqe dhe kundërthënie, çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë është gjithmonë e më e pranishme në narrativët politikë të partive kryesore politike dhe organizatave të tjera përfshirë edhe median. Po kështu, mbështetja e publikut *për bashkimin* gjatë të njëjtës periudhë është rritur në mënyrë befasuese, spektakulare. Nëse në tetor 2018 në Shqipëri do të ishte zhvilluar një referendum për bashkimin apo jo të Shqipërisë dhe Kosovës, 74,8 për qind e qytetarëve do të kishin votuar “*pro*” këtij bashkimi.¹¹ Ndërsa nëse ky referendum do të ishte zhvilluar në Kosovë, varianti i “bashkim-

it” gjithashtu do të kishte “fituar “ ndonëse me një rezultat më të ngushtë, 63,9 për qind.¹²

Ku po shkon Shqipëria dhe Kosova? Studimi në vijim shqyrton në mënyrë kritike çështjen e bashkimi të Shqipërisë me Kosovën duke tentuar t’iu japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme: A po shkojnë Shqipëria dhe Kosova drejt një bashkimi? A është realisht i dëshirueshëm bashkimi i të dy shteteve? Përse duhet të bashkohen Shqipëria dhe Kosova? A është i mundshëm ky bashkim? A është bashkimi një alternativë ndaj integritetit evropian? A e përjashtojnë njëra tjetrën integriteti evropian dhe *bashkimi kombëtar*? Cilat do të ishin implikimet e mundshme në mjedisin e brendshëm për Shqipërinë dhe për shtetin që do të ishte produkt i bashkimit? Dhe së fundi, por jo e fundit për nga rëndësia, në rastin e një bashkimi, cilat do të ishin implikimet potenciale në marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit të ri, që do të lindte nga ky bashkim?

SHËNIME

- 1 Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. *Platforma për Zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare*, Tiranë, 1998.
- 2 Bota Sot. 2018. “Edi Rama: Kosova dhe Shqipëria do ta kenë një president të përbashkët të Unitetit Kombëtar”. Akseluar më: 18/02/2018 <https://www.botasot.info/lajme/837341/edi-rama-kosova-dhe-shqiperia-do-ta-kene-nje-president-te-perbashket-te-umitetit-kombetar/>
- 3 Time.al. 2018. “Serbia me tre fytyra, Shqipëria e Kosova me një fytyrë, kuq e zi” Akseluar më: 20/05/2020 <http://time.ikub.al/18-11-26-Fjalimi-kuq-e-zi-i-kryeministrit-te-Shqiperise-ne-mbledhjen-e-dy-Queverive703980/Serbia-me-tre-fytyra-Shqiperia-e-Kosova-me-nje-fytyre-kuq-e-zi-.aspx>
- 4 Platforma, Akademia e Shkencave, f. 41.
- 5 Mbledhja e parë e përbashkët e të dy qeverive, që u konsiderua një zhvillim historik u vendos të mbahej në Prizren, për ta lidhur këtë mbledhje të parë të të dy qeverive me simbolikën historike të lëvizjes për bashkim kombëtar, me Lidhjen e Prizrenit të formuar në Prizren më 1878.
- 6 Zëri. 2019. “Edi Rama paralajmëron bashkimin e Kosovës me Shqipërinë!” Akseluar më: 20/05/2020 <https://zeri.info/aktuale/235135/edi-rama-paralajmeron-bashkimin-e-kosoves-me-shqiperine/>
- 7 Shehu, Bekim 2019. “Heqja e kufirit Kosovë-Shqipëri bashkim apo lehtësim i procedurave?” Radio DW, 12/02/2019 <https://www.dw.com/sq/heqja-e-kufirit-kosov%C3%AB-shqip%C3%ABri-bashkim-apo-leht%C3%ABsim-i-procedurave/a-47059880>
- 8 Fevziu, Blendi. 2018. “A është qëllim bashkimi i Shqipërisë me Kosovën?” Opinion, TV Klan. 20/09/2018
- 9 Mapo. 2018. “Bashkim Kombëtar deri në 2025-ën: Rama shpall projektin Kosovë-Shqipëri” Akseluar më: 20/05/2020 <https://gazetamapo.al/bashkim-kombetar-deri-ne-2025-en-rama-shpall-projektin-kosove-shqiperi/>
- 10 The Economist. 2020. “For Europe, geopolitics starts at home.” The Economist, January 18, 2020 <https://www.economist.com/europe/2020/01/18/for-europe-geopolitics-starts-at-home>
- 11 Demi, Agron dhe Blendi Ceka. 2019. *Kosovo-Albania Interaction, Knowledge, values, beliefs, cooperation and unification*. Kosova Foundation for Open Society, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë 2019, f. 12.
- 12 Po aty.

Kapitulli I

SHQIPËRIA DHE KOSOVA: NJË VËSHTRIM HISTORIK

Njohja nga Fuqitë Europiane më 1913 i një shteti shqiptar nuk e zgjidhi përfundimisht dhe në mënyrë të kënaqshme çështjen kombëtare shqiptare. Lënia jashtë kufijve shtetërorë e pothuajse gjysmës së territoreve të banuara nga shqiptarët përcaktoi thelbin e ri të çështjes kombëtare, i cili është i pandryshueshëm edhe tani, pas më shumë se njëqind vjetësh: bashkimin e të gjitha ish-territoreve shqiptare të cilat u lanë jashtë kufijve shtetërorë kur u themelua dhe u njoh shteti shqiptar.

Objektivat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ishin realizuar pjesërisht me pavarësimin nga Perandoria Otomane dhe njohjen e një shteti shqiptar. Objektivat e reja të Lëvizjes Kombëtare dhe të shtetit të ri të sapokrijuar synonin restaurimin e Shqipërisë etnike, bashkimin me shtetin shqiptar të të gjitha territoreve të

banuara nga shqiptarët

Gjatë më shumë se njëqind vjetëve të historisë së shtetit shqiptar, Shqipëria dhe Kosova kanë funksionuar si dy shoqëri, ekonomi dhe tregje të ndara. Krijimi, për një kohë të shkurtër, i një *Shqipërie natyrore*, pothuajse në kufijtë e saj etnikë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga Gjermania naziste, mbeti shumë larg funksionimit të një shteti unitar, me një qeverisjeje hierarkike qendrore dhe lokale, me një treg të integruar dhe ekonomi të përbashkët. Pas Luftës së Dytë Botërore Kosova u përfshi brenda Jugosllavisë, kurse Shqipëria u mbyll gradualisht në vetvete deri në një izolim ekstrem. Gjatë viteve të vështira 1990, kur regjimet komuniste u shembën dhe Jugosllavia filloi të shpërbëhej përmes dhunës dhe konflikteve të përgjakshme, nuk ishte e mundur të vendoseshin komunikime dhe bashkëveprime dhe aq më pak lidhje ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, ndërsa kufijtë midis tyre shëmbëllenin shumë me periudhën e Luftës së Ftohtë. Kufiri midis Shqipërisë dhe Kosovës, që formalisht ishte kufiri midis Shqipërisë dhe Serbisë dhe Malit të Zi, ra në mënyrë të dhunshme pas fillimit të luftës në Kosovë, kur të paktën gjysmë milion kosovarë kaluan kufirin dhe gjetën strehë në Shqipëri.

Kosova si komponent themelor i çështjes kombëtare shqiptare

Kur është fjala për *bashkimin kombëtar*, që praktikisht do të thotë bashkimi në një shtet të vetëm i të gjithë territoreve të banuara nga shqiptarët, në Shqipërinë Otomane, Kosova është qendrore për të gjitha arsyet e mundshme: historike, gjeografike, kulturore, ekonomike.¹³ Kosova ishte djepi i nacionalizmit

shqiptar.¹⁴ Lëvizja Kombëtare Shqiptare për pavarësi filloi në Kosovë me Lidhjen e Prizrenit.

Pas njohjes së shtetit shqiptar, më 1913, ishin dy argumente që përcaktuan dhe rikonceptuan çështjen kombëtare dhe narrativin themelor rreth saj: Së pari, shqiptarët e konsideronin një padrejtësi vendimin e Fuqive të Europës për njohjen e shtetit shqiptar duke lënë jashtë këtyre kufijve shtetërorë gjysmën e territoreve. Njohja e shtetit shqiptar ishte në të njëjtën kohë edhe copëtimi i territoreve shqiptare. Kësisoj bashkimi i Kosovës dhe i territoreve të tjera shqiptare me shtetin e porsakrijuar ishte zgjidhja e një padrejtësie historike. Edhe sot, pas më shumë se njëqind vjetësh, perceptimi si padrejtësi dhe korrigjimi i kësaj padrejtësie historike është edhe forca shtytëse e idesë së bashkimit në atë masë që kjo ide ekziston në Shqipëri, në Kosovë apo edhe në diasporën shqiptare në Perëndim.

Argumenti i dytë, barabar i rëndësishëm dhe sigurisht i lidhur me argumentin e parë, kishte të bënte me funksionimin, qëndrueshmërinë dhe ecurinë e shtetit shqiptar të njohur më 1913. Shqipëria e cunguar nuk mund të bëhej kurrë një shtet funksional.¹⁵ Përcaktimi dhe njohja ndërkombëtare e kufijve të shtetit shqiptar ka qenë historike dhe njëherazi kritike për funksionimin e madje edhe për të ardhmen e një shteti shqiptar. Në prag të Luftës së Parë Botërore, kur po merrte fund eksperimenti i Fuqive të Europës për një principatë-mbretëri shqiptare me Princ Vidin, sekretari privat i tij paralajmëronte pikërisht pamundësinë e funksionimit të një shteti, nga kufijtë e të cilit ishin përjashtuar gjysma natyrore e territoreve, tregjeve dhe qytetërimeve të tij:

“Kufijtë e mbretërisë së re nuk i kënaqën shqiptarët, që e shihnin veten të përgjysmuar dhe pa pjesën më të madhe të qyteteve të tyre më të mëdha. Qytete të pastra shqiptare, me tregje të konsoliduara, që mbulonin zona të tilla si Gjakova, Prizreni, Dibra dhe Struga, iu dhanë Serbisë dhe Malit të Zi. Banorët e Shqipërisë Veriore dhe Lindore u shkëputën nga tregjet e tyre dhe nga qytetërimi i tyre.... kjo shkëputje hodhi themelet e trazirave të ardhshme.”¹⁶

Argumentet rreth pamundësisë së Shqipërisë për të qenë një shtet funksionues, për shkak se territoret, funksionimi dhe qytetërimi i përbashkët i tyre, u ndërpre në mënyrë arbitrare më 1913, kanë qenë dhe janë ende themelore në narrativin e bashkimit kombëtar.

Edhe sot, pas më shumë se njëqind vjetësh, këto janë argumente në narrativin e bashkimit kombëtar, por janë gjithashtu themelore edhe në mobilizimin politik të individëve dhe partive politike në diasporën shqiptare në Perëndim, në Shqipëri dhe përbëjnë pjesë themelore edhe në programet politike të organizatave dhe partive politike, midis të cilave më e rëndësishmja është Vetëvendosja në Kosovë.¹⁷

Historikisht, narrativet mbizotëruese, kur është fjala për “çështjen kombëtare” në Shqipëri, në Kosovë dhe sidomos në diasporën shqiptare në vendet perëndimore, kanë në themel kryesisht argumentin e parë, “atë të padrejtësisë historike dhe copëtimit të trojeve shqiptare” dhe idealin për të korrigjuar këtë padrejtësi. Megjithatë, në rastin më të mirë, frymëzuesit dhe udhëheqësit e bashkimit kombëtar me formacionet e tyre poli-

tike i kombinojnë të dy argumentet: atë të “korigjimit të një padrejtësie historike,” por edhe domosdoshmërinë e bashkimit të Kosovës dhe territoreve të tjera me Shqipërinë si një *sine qua non* për të pasur një shtet të fortë dhe funksionues.

Në dekadën e parë të shtetit të ri shqiptar ka qenë mbizotëruese teza, sipas së cilës, shteti shqiptar nuk mund të jetë i qëndrueshëm për shkak të copëtimit të territoreve shqiptare.¹⁸ Megjithatë, teza “e padrejtësisë historike” dhe e *domosdoshmërisë së zgjidhjes së kësaj padrejtësie* historikisht ka qenë konsistente, e vazhdueshme dhe më popullore. Madje kjo tezë ka qenë e pranishme edhe në Shqipërinë e kohës së komunizmit, gjatë Luftës së Ftohtë, ku përgjithësisht çështjet nacionale u konservuan.

Ndonëse në një rrafsh teorik, zgjidhja e plotë e çështjes kombëtare shqiptare përfshin bashkimin në një shtet të vetëm të të gjitha territoreve të banuara nga shqiptarët, të cilat më 1913 mbetën jashtë kufijve shtetërorë,¹⁹ në një rrafsh më praktik, *me bashkimin kombëtar* është nënkuptuar bashkimi i Kosovës me Shqipërinë për disa arsye: përveç faktit që historikisht ka përbërë zemrën e çështjes kombëtare, Kosova ndërkaq, ka pasur një territor dhe një popullsi kompakte, ka qenë dhe vijon të jetë një njësi unitare ekonomike dhe kulturore. Si njësi unitare ekonomike dhe kulturore, Kosova deri në themelimin dhe njohjen e shtetit shqiptar më 1913, ka qenë pjesë e një njësie ekonomike kulturore më të madhe, Shqipërisë Otomane. Në shtator të vitit 1912, kur qeveria turke, pas revoltave të shqiptarëve, pranoi të njihte një shtet autonom shqiptar, që, në fakt, ishte dhe mbeti thjesht një projekt, Vilajeti i Kosovës ishte një komponent qendror, krahas Vilajeteve të Shkodrës, Janinës dhe Manastirit.²⁰

Identifikimi i çështjes kombëtare kryesisht me Kosovën është i dukshëm në të gjithë trajektoren historike të shtetit shqiptar, pavarësisht nga regjimet e ndryshme që kanë qeverisur gjatë më shumë se njëqind vjetëve të fundit. Në debatin politik që shoqëroi krijimin e shtetit shqiptar dhe “copëtimin e trojeve shqiptare” të paktën deri në dekadën e parë, Kosova ishte qendrore.

1913-1990, në kërkim të vendit amë

Më 1913, kur fuqitë europiane shkuan drejt njohjes së një shteti shqiptar, duke i copëtuar territoret shqiptare, shteti që u krijua, Shqipëria, ishte *shteti amë* në raport me Kosovën dhe popullsinë tjetër shqiptare, që përbënte komunitete kompakte në Mbretërinë e Jugosllavisë, kurse pas Luftës së Dytë Botërore, në Federatën Jugosllave. Dinamika e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës në një trajektore që zë fill nga njohja ndërkombëtarisht e të parës si shtet deri në shpalljen e të dytës si shtet i pavarur, më 2008, ka qenë përcaktuar përveç situatave ndërkombëtare, rolit dhe influencës së Fuqive të Mëdha, rolit dhe ambicieve të vendeve fqinje të Ballkanit, edhe nga një faktor kritik dhe konstant: nga shteti historikisht i dobët i Shqipërisë me një varësi kritike nga jashtë, i kërcënuar dhe i rrezikuar historikisht.

Në rrethana të tilla Shqipëria nuk mundi të luante dot rolin e *shtetit amë* kundrejt shqiptarëve që mbetën jashtë kufijve shtetërorë me statusin e minoritetit.

Pavarësia e Shqipërisë nuk ka qenë një akt i vetëm, por një proces relativisht i gjatë, në të cilin dekada e parë pas shpalljes së pavarësisë ka qenë kritike për vetë ekzistencën e shtetit që sapo ishte krijuar. Në mbarim të Luftës të Parë Botërore, në Konfer-

encën e Paqes, Shqipëria i shpëtoi një copëtimi të ri të territoreve që i ishin njohur qysh më 1913.²¹ Në një mjedis ndërkombëtar armiqësor ishte krejtësisht e pamundur që Shqipëria të ndërmerre ndonjë hap për të kërkuar që Kosova apo territore të tjera në Ballkan t'i bashkoheshin shtetit të saj. Çështja Shqiptare përfundimisht u vendos më 1921, me Konferencën e Ambasadorëve, e cila riafirmoi kufijtë e vitit 1913, ndarje, sipas të cilës, Kosova mbetej jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë.

Edhe ardhja e Zogut në pushtet, fillimisht si president, më 1925 dhe më pas, më 1928, si mbret, nuk solli ndonjë ndryshim. Shqipëria vijoi të ishte një shtet i dobët, fare pranë një shteti të dështuar. Në këto rrethana të brendshme, si dhe rrethana ndërkombëtare krejtësisht të pafavorshme, qeveria apo shteti shqiptar e kishte vështirë t'i përkushtohej çështjes kombëtare. Dobësia kronike e shtetit shqiptar qysh në lindje të tij e ka bërë shumë të vështirë, në mos të pamundur, kërkimin e bashkimit të Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare me shtetin shqiptar. Gjatë qeverisjes së Mbretit Zog, interesat shtetërore morën prioritet mbi interesat kombëtare dhe kjo u pa qartë në faktin se Kosova nuk ishte më në axhendën e qeverisë. Madje Mbreti Zog adoptoi politikat kufizuese ndaj aktivitetit politik të udhëheqësve dhe veprimtarëve kosovarë të vendosur në Tiranë, por arsyet për këtë duhen kërkuar edhe te lufta e brendshme politike për pushtet brenda përbrenda Shqipërisë. Disa nga kundërshtarët politikë të Zogut ishin eksponentë të njohur të Kosovës.²²

Në luftën e brendshme politike midis dy partive politike pas Kongresit të Lushnjës, udhëheqës të njohur të Komitetit të Kosovës,²³ ishin shpallur publikisht kundërshtarë të Zogut. Në dhjetor 1921, kur Ahmet Zogu mori kontrollin e qeverisë duke vendosur edhe gjendjen e shtetrrëhimit, hapi i parë që

ndërmori ishte marrja e mandateve parlamentare udhëheqësve të Komitetit të Kosovës,²⁴ me arsyetimin se komiteti po shkatërronte normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë.²⁵

Por nën qeverisjen e Ahmet Zogut, marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën u përcaktuan në një masë të konsiderueshme nga politika e jashtme e tij ndaj Jugosllavisë. Dhe kjo politikë e jashtme u ndikua mjaft nga fakti se Zogu e rrëzoi qeverinë e Fan Nolit, në dhjetor 1924, me ndihmën e Jugosllavisë.

Gjate Luftës së Dytë Botërore, e ardhmja e Kosovës ishte një çështje themelore, që ndau dy grupet e rezistencës, lëvizjen nacionalçlirimtare, të dominuar nga komunistët dhe lëvizjen nacionaliste, të drejtuar nga Balli Kombëtar.²⁶

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjermanët deklaruan prej ditës së parë të hyrjes në Shqipëri se dëshironin një Shqipëri me kufijtë e saj etnikë dhe në ndërtimin e Shqipërisë gjermane, Kosova kishte një rëndësi strategjike. Gjermanët deklaruan qartë se vetëm me ardhjen e tyre mund të arrihej bashkimi i vërtetë i Kosovës me Shqipërinë. Po kështu, gjermanët sollën në vëmendje të publikut shqiptar se aleatët kishin mbajtur dhe vijonin të mbanin heshtje ndaj Kosovës dhe të ardhmes së saj, duke lënë të kuptohej se ata, pra, aleatët, dëshironin që Kosovën t'ia dorëzonin sërish Jugosllavisë.²⁷

Nga ana tjetër, çështja e Kosovës nën projektin gjerman nuk nënkuptonte thjesht bashkimin e territorit dhe popullsisë me “vendin amë”, por luante një rol të rëndësishëm në qeverinë dhe administratën që qeverisi “Shqipërinë e Madhe” deri në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Ndërkaq në marrëdhëniet e tyre të ngushta, Partia Komu-

niste e Shqipërisë dhe ajo e Jugosllavisë gjatë luftës duket se ishin pajtuar se i vetmi korrigjim që mund të bëhej në kufijtë e ardhshëm ishte ndryshimi i statusit të Kosovës. Pavarësisht nga fakti se jugosllavët zotoheshin se pas luftës do të respektonin parimin e të drejtës së vetëvendosjes, fjala ishte gjithmonë për Kosovën.²⁸

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, Kosova u përfshi në Federatën Jugosllave,²⁹ pavarësisht premtimeve të Titos dhe pavarësisht vullnetit të lëvizjes partizane në Kosovë, që mbështeti në mënyrë të vazhdueshme bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Shqipëria dhe Kosova, e para si shet i pavarur dhe e dyta si pjesë e Federatës Jugosllave funksionuan pothuajse për pesë dekada krejtësisht të izoluar nga njëra tjetra, pa ndonjë marrëdhënie domethënëse. Këtu bën përjashtim një periudhë shumë e shkurtër e gjallërimit të marrëdhënieve dhe kontakteve në fillim të viteve shtatëdhjetë. Shqipëria dhe Jugosllavia patën një moment të dytë afrimi pas prishjes në vitin 1948, nën frikën e një kërcënimi të përbashkët që mund të vinte nga Bashkimi Sovjetik. Punët shkuan deri aty sa përveç armëpushimit të luftës propagandistike kundër Beogradit, Tirana deklaroi se do t'i vinte në ndihmë Jugosllavisë në rastin e një sulmi nga Bashkimi Sovjetik.³⁰ Gjithsesi, ky *muaj* i dytë *i mjaltit* shërbeu për të vendosur dhe gjallëruar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës e në mënyrë të veçantë në fushën akademike, të arsimit, të kulturës dhe mediave. Promotorët e këtij bashkëpunimi ishin dy universitetet përkatëse, por edhe qendrat kulturore, televizionet, shtëpitë botuese dhe shoqatat e shkrimtarëve.³¹

Kjo ishte një pranverë shumë e shkurtër, që u ndërpre për tu kthyer te izolimi i plotë që përgjithësisht ka dominuar marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore dhe për pasojë ka krijuar ndarje më të mëdha midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe procesi i ndërtimit të shtetit dhe i zhvillimit të shoqërisë në Shqipëri dhe në Kosovë ishte i ndryshëm. Ndërsa Shqipëria komuniste ishte rasti më ekstrem i diktaturave në ish-lindjen komuniste, Kosova funksionoi përgjithësisht me një regjim liberal dhe të hapur me botën përkundër izolimit ekstrem të Shqipërisë. Ndonëse edhe në Shqipëri edhe në Kosovë shoqëritë mbetën tradicionale dhe funksiononin bazuar kryesisht te klani, ato zhvilluan kultura të ndryshme politike. Me gjithë politikat diskriminuese dhe shtypëse të ndjekura nga Beogradi, shqiptarët në Kosovë gëzonin lirinë e lëvizjes,³² të arsimimit, të besimit fetar dhe të drejtën e pronës private, të cilat në Shqipëri mbetën një ëndërr deri në vitin 1990.

Këto realitete ekstreme kanë krijuar diferenca në raportet e individëve dhe dy shoqërive kundrejt ligjit dhe shtetit. Në një farë mënyre, Lufta e Ftohtë i thelloi edhe më shumë dallimet midis dy shoqërive shqiptare, asaj në Shqipëri dhe shoqërisë shqiptare në Kosovë.³³

Gjatë gjithë kësaj periudhe mungoi komunikimi dhe dallimet u thelluan. Qeveria e Shqipërisë e injoroi çështjen e Kosovës. Me ardhjen në pushtet të komunistëve në Shqipëri dhe deri në fund të Luftës së Ftohtë, çështja e Kosovës pothuajse u arkivua. Regjimi komunist në Shqipëri kishte krijuar brenda vendit, por edhe jashtë tij, një perceptim nacionalist, por praktikisht interesat kombëtare ishin periferike dhe dytësore, nëse nuk mungonin krejt. Përparësi kishte internacionalizmi komunist dhe

marksizëm-leninizmi si ideologji.

Megjithëse regjimi dhe propaganda e tij flisnin për atdheun, kombin, historinë, luftërat, padrejtësitë historike, armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, me të cilat ishte krijuar miti i një kombi të pathyeshëm, Kosova dhe përgjithësisht çështja kombëtare, nuk ishin as pjesë e këtij narrativi nacionalist dhe afërmendsh as e politikave dhe aksioneve në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë komuniste. Është e vërtetë se mbijetesa e regjimit dhe ruajtja e pushtetit kishin prioritet të padiskutueshëm dhe regjimi ishte i gatshëm të sakrifikonte gjithçka për të ruajtur pushtetin.

Ndërkaq, gjatë gjithë Luftës së Ftohtë, Shqipëria komuniste ishte shumë e dobët për t'u kujdesur për Kosovën apo ish-territoret e tjera në Jugosllavi. Në rrethanat kur ishte thjesht një shtet klient i Jugosllavisë,³⁴ nuk kishte gjasa që Shqipëria të luante rolin e *shtetit amë* kundrejt Kosovës dhe aq më pak të kërkonte bashkimin e Kosovës me atdheun mëmë. Edhe “prishja” e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe afrimi i Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, një nga dy fuqitë botërore, nuk solli asnjë ndryshim në politikën e jashtme të Shqipërisë në përgjithësi dhe në marrëdhëniet me Kosovën në veçanti. Afrimi i Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik e përkeqësoi më shumë situatën dhe një politikë e jashtme e pavarur ishte krejtësisht e pamundur. Siç rezultoi edhe më vonë në marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën dhe prishjen e këtyre marrëdhënieve, i vetmi sovranitet në punët e jashtme që Shqipëria komuniste manifestoi gjatë Luftës së Ftohtë ishte politika vetizoluese, të cilën nuk u përpoq ta ndalonte askush.

Deri në fund të regjimit komunist në Shqipëri, Kosova për shqiptarët e Shqipërisë ishte një mit për të cilin flitej gjithmonë e më pak: Përtej kufijve shtetërorë jetonte gjysma tjetër e kombit, por kufijtë ishin të pakapërcyeshëm.

Çështja e bashkimit pas Luftës së Ftohtë

Me fundin e Luftës së Ftohtë, me rënien e komunizmit në Shqipëri dhe fillimin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave, u rikthye debati rreth çështjes kombëtare dhe zgjidhjes së saj: bashkimit të Kosovës, por edhe të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm, Shqipërinë.

Zgjidhja e çështjes kombëtare përmes bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm, bazohej sërish te teza e korrektimit të një padrejtësie historike, që kishte çuar në copëtimin e territoreve, por edhe te teza e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të shtetit “amë”. Me fillimin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë ishte një nga opsionet që, të paktën teorikisht, nuk mund të përjash-tohej. Për disa qarqe nacionaliste, periferike, brenda Shqipërisë dhe qarqeve më të angazhuara dhe të spikatura në diasporën shqiptare në Perëndim, bashkimi i Kosovës me *vendin amë* do të shënonte zgjidhjen, pothuajse të plotë,³⁵ të çështjes kombëtare.

Në programin politik të Partisë Demokratike, partia e parë opozitare më 1990, si dhe në programet e partive të tjera politike, që vijuan të krijoheshin apo shoqatave patriotike, zinte vend të rëndësishëm “çështja kombëtare” dhe veçanërisht Kosova. Në vitin 1998, Akademia e Shkencave të Shqipërisë,

publikoi platformën për zgjidhjen e çështjes kombëtare në themel të së cilës ishte “bashkimi i të gjitha territoreve në një shtet shqiptar të unifikuar.”³⁶ Në paketën kushtetuese të vitit 1992 si dhe në preambulën e kushtetutës së vitit 1998, por edhe pas ndryshimeve të vitit 2008, Shqipëria njihje legjitimitetin dhe *aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar*.³⁷ Mirëpo pavarësisht kushtetutës, programeve të partive politike, platformës së Akademisë apo diskursit të mediave për njohjen dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare përmes bashkimit të Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare me Shqipërinë në një shtet të vetëm, të unifikuar, praktikisht, qeveria e parë jokomuniste dhe qeveritë, që ndërruan njëra-tjetrën, nuk formuluan dot ndonjë politikë konkrete dhe nuk ndërmorën asnjë veprim konkret.

Pas rënies së regjimit komunist, një numër faktorësh përcaktuan orientimin dhe politikën e Shqipërisë ndaj Kosovës dhe përgjithësisht të asaj që ende konceptohet dhe emërtohet si çështja kombëtare. Së pari, Shqipëria doli nga komunizmi me një shtet shumë të dobët, nëse jo të dështuar, me një ekonomi të falimentuar, ndërsa nuk mund të flitej për kapacitetet ushtarake, me gjithë militarizimin e ekonomisë dhe të shoqërisë shqiptare. Shqipëria, më 1990, e kishte krejtësisht të pamundur të hynte në luftë për Kosovën, kur edhe për mbrojtjen dhe sigurinë e saj nuk mund të mbështetej në kapacitetet e veta njerëzore, ushtarake apo ekonomike.

Së dyti, jo vetëm në vitin 1990, kur ishte një shtet pothuajse i dështuar, por edhe më pas, madje edhe tani që kanë kaluar disa dekada dhe vendi është anëtar i NATO-s, Shqipëria nuk është në gjendje të demonstrojë pavarësi në punët e jashtme dhe aq më pak të jetë sovrane, sidomos kur është fjala për marrëdhëniet me

Kosovën apo ish-territore të Shqipërisë otomane në Ballkan, të cilat prej vitit 1913 kanë qenë dhe vijojnë të jenë pjesë e territoreve të shteteve të njohura ndërkombëtarisht.

Deri në vitin 2008, Kosova, të paktën teorikisht, vijonte të ishte pjesë e çështjes kombëtare shqiptare. Gjatë pothuaj tre dekadave qysh nga rënia e komunizmit, Shqipëria nuk kishte shfaqur ambicie për ta parë të ardhmen e Kosovës si pjesë të territorit të saj. Nga ana tjetër, Tirana, pavarësisht nga programet politike të partive apo angazhimet dhe detyrimet që i njihje edhe në dokumentin themelor të shtetit, kushtetutën, praktikisht nuk ndërmoi asnjë hap konkret për të mbështetur ndonjë prej opsioneve të formuluar nga udhëheqësit e Kosovës apo partive të tjera shqiptare në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Me një shtet të dobët dhe me një varësi gati jetike nga jashtë, shteti shqiptar thjesht mbështeste politikën e Perëndimit në Ballkan dhe posaçërisht ato në drejtim të Kosovës.

Në dy prej momenteve kyçe për të ardhmen e Kosovës, më 1991, kur u pa qartë se Jugosllavia po shkonte drejt shpërbërjes dhe më 1997-1998, kur shpërtheu lufta në Kosovë, Shqipëria përjetonte krizat më të rënda të historisë së saj moderne. Prej vitit 1991, kur gjendej në kufijtë e mbijetesës, Shqipëria e shikonte të ardhmen e Kosovës në *krijimin e hapësirave demokratike*³⁸ në Jugosllavi, praktikisht pa mbështetur asnjë nga opsionet e formuluar nga udhëheqësit politikë të Kosovës. Ndërsa më 1997-1998, kur *de facto* pothuajse kishte pushuar së ekzistuari si një shtet, duke humbur edhe kontrollin mbi territorin dhe kufijtë e vet, Shqipëria e mbështeste respektimin e pakicave shqiptare në Jugosllavinë e mbetur, duke pranuar kështu se Kosova ishte një çështje e brendshme e Serbisë. Në nëntor të vitit

1997, në Samitin e Kretës,³⁹ Kryeministri i Shqipërisë, në takim me Millosheviçin, kërkoi trajtim të barabartë për sa u takon të drejtave njerëzore dhe lirive të shqiptarëve në Jugosllavinë e mbetur.⁴⁰

Qëndrimi i mëtejshëm i Tiranës ka evoluar, por gjithmonë duke u akomoduar me zhvillimet në terren dhe sigurisht me qëndrimin e komunitetit ndërkombëtar, duke mbërritur deri në mbështetje për pavarësinë e Kosovës. Të dyja, edhe Shqipëria, edhe Kosova u zotuan, kjo e fundit edhe përmes kushtetutës së saj, për mos ndryshimin e kufijve ndërkombëtarë të shtetit të ri të Kosovës dhe në mënyrë të veçantë për mos bashkimin me Shqipërinë.

Megjithatë, edhe pas shpalljes së pavarësisë, më 2008 dhe njohjen e Kosovës si shtet i pavarur,⁴¹ bashkimi me Shqipërinë vijon të jetë një opsion, por jo më si bashkim i një territori dhe popullsisë përkatëse, të lënë jashtë kufijve shtetërorë më 1913 nga *shteti amë*, por si një bashkim i dy shteteve të pavarura.

- 13 Kosova kishte qenë një nga katër vilajetet në Shqipërinë Otomane. Shiko Malcolm, Noel. 1998 *Kosovo a Short History*, Chapter 6, Early Ottoman Kosovo: 1450s-1580s, Pan Books.
- 14 Skëndi, Stavro. 1967. *The Albanian National Awakening, 1878-1912* (Princeton).
- 15 Biberaj, Elez. 2000. *The Albanian National Question* (New York: New York Council of Foreign Relations Press)
- 16 Heaton- Armstrong, D. 2012. *Prince Wied: The six months Kingdom*. Tirana: Albanian Institute for International Studies, AIIS f.7
- 17 Neni 1 i Statutit të Vetëvendosjes në Kosovë parashtroi se Lëvizja «synon një Kosovë sovraane, pra një Kosovë, që ka kontroll në burimet natyrore të saj dhe që e gëzon të drejtën për të pasur një forcë ushtarake të pavarur të veten, si dhe të drejtë për bashkimin me Shqipërinë.» Aksesuar më 24/02/2019: <https://www.vetevendosje.org/statuti/> Sakaq, në Shqipëri, Aleanca Kuq e Zi parashtroi misionin e saj që kjo parti ka për “synim të mbrojtë Kushtetutën e Republikës, të mbrojtë dinjitetin njerëzor duke e shndërruar në një simbol rezistence për çështjen kombëtare,” por pa iu referuar specifikisht bashkimit me Kosovën.
- 18 Heaton Armstrong, D. 2012. *Prince Wied, the sixth month kingdom*. Tirana: AIIS Publications.
- 19 Bashkimi i pastër kombëtar për nacionalistët shqiptarë do të përfshinte bashkimin në një shtet të vetëm, jo vetëm trojet të cilat iu dhanë ish-Jugosllavisë, por edhe territore të tjera si Çamëria, etj.
- 20 Pano, Nicholas C. 1968. *The Peoples’s Republic of Albania*. New York: John Hopkins Press.
- 21 Woodall, Robert Larry. 2019. *Albanian problem at Paris Peace Conference*. Tirana: AIIS.
- 22 Fischer, Bernd J. 2015. *King Zog and the struggle for stability in Albania*. Tirana: AIIS.
- 23 Për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” shih https://sq.wikipedia.org/wiki/Komiteti_Mbrojtja_Kombëtare_e_Kosovës
- 24 Komiteti për mbrojtjen kombëtare të Kosovës u themelua në Shkodër në Nëntor të vitit 1918 nga një grup i shquar i udhëheqësve politikë të Kosovës me në krye Hasan Prishtinën. Komiteti synonte përfshirjen e Kosovës brenda kufijve të shtetit shqiptar. Shiko Malcolm, Noel. 1998 *Kosovo a Short History*, Chapter 14.
- 25 Pollo, Stefanaq and Arben Puto. 1981. *The History of Albania, from its origin to the present day*. London Boston and Henley: Routledge and Kenan Paul, f. 186-187.
- 26 Pano, Nicholas. 1968. *The Peoples’s Republic of Albania*. New York: John Hopkins Press.
- 27 Fischer, Bernd J. 1999. *Albania at War, 1939-1945*. London: Hurst & Company
- 28 Në kongresin e katërt, më 1928 dhe në konferencën e V, më 1940, Partia Komuniste

Jugosllave kishte mbështetur kthimin e Kosovës te Shqipëria, sipas Paul Lendvai në “Eagles in cobwebs: Nationalism and communism in the Balkans”, cituar nga Elez Biberaj në “Çështja kombëtare shqiptare”.

- 29 Shiko Malcolm, Noel. 1998. *Kosovo a Short History*, Chapter 16. Kosova under Tito: 1945-1980. Për marrdhenjet midis Shqipërisë dhe Kosovës gjatë kësaj periudhe shiko Elez Biberaj 2000. *The Albanian National Question* (New York: New York Council of Foreign Relations Press)
- 30 Biberaj, Elez. 2014. *Çështja Kombëtare Shqiptare*. Tirana: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, f.30.
- 31 U nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi midis Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe pari shkëmbime akademike të ndërsjella, kryesisht midis profesorëve të të dy universiteteve; u ndërmorën projekte të përbashkëta në fushat shkencore dhe të kulturës përfshirë botimet. Shih Sabit Syla, Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981, kapitulli i katërt, Instituti i Historisë Prishtinë. Prishtinë, 2012.
- 32 Tingëllon shumë ironik fakti se aktualisht qytetarët e Kosovës duhet të pajisen me vizë për të vizituar vendet europiane, por edhe SHBA, si edhe vende të tjera perëndimore, pa llogaritur sigurisht vendet që ende nuk e njohin shtetin e Kosovës, kur 30 vjet më parë ishin të lirë të udhëtonin pothuajse në çdo vend të botës (por jo në Shqipëri!)
- 33 Intervistë me Arben Hajrullahun: kosovari me përkatësi etnike shqiptare prej Graçanicës dhe një kosovar me përkatësi etnike serbe nga Graçanica besoj se kanë më shumë të përbashkëta në aspektin e jetës sociale, se si e kuptojnë mënyrën e jetesës, mënyrën se si e zhvillojnë jetën, për shkak të përvojave të përbashkëta, sesa të themi ky serbi i Graçanicës me një serb të Beogradit, ose shqiptari i Graçanicës me një shqiptar të Gjirokastrës.
- 34 Krisafi, Ledion. 2017. *Shqipëria dhe Jugosllavia: Mitet, faktet dhe dyshimet (1945-1948)* Tiranë: Naimi.
- 35 Për këto qarqe nacionaliste, zgjidhja e plotë dhe e drejtë e çështjes kombëtare shqiptare është bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare në një shtet të vetëm.
- 36 Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Platforma për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare*. Tirana, 1998
- 37 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Aksesuar më 12/10/2019 <http://president.al/wp-content/uploads/2018/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>
- 38 Intervistë me një ish-zyrtar të lartë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- 39 Albania's PM meets Yugoslav President. Albanian Telegraphic Agency (ATA) 1997. Ndërsa përflitej mbi mundësinë e takimit Nano-Miloshevic, qeveria e Kosovës nga Boni lëshoi një deklaratë të dërguar me faks në zyrat ku mbahej samiti, në të cilën deklarohesh se ‘askush nuk mund të flasë mbi çështjen e Kosovës në mungesë të përfaqësuesve legjitim të Kosovës, të zgjedhur nga vullneti i popullit.’
- 40 Goro, Robert. “FYROM: Supremacia e inferioritetit” Kurier, 2001.
- 41 Deri më 2019 kishte 111 shtete të OKB-së që e kanë njohur.

Kapitulli II

BASHKIMI I KOSOVËS ME SHQIPËRINË: PERCEPTIME DHE REALITETE

Gjatë dekadës së fundit, gjatë së cilës Shqipëria dhe Kosova kanë qenë duke u përpjekur të akomodojnë marrëdhëniet si shtete të pavarura, çështja e bashkimit në një shtet të vetëm, si një nga opsionet e mundshme për të ardhmen e përbashkët është duke “u debatuar dhe zhvilluar” në dy sfera të ndryshme, të cilat, nuk janë në mënyrë të domosdoshme ekskluzive dhe përjashtuese. Njëra është sfera imagjinare, sentimentale, e perceptimeve, e përdorimit të simboleve e koncepteve dhe ideve me të cilat është ndërtuar dhe interpretohet historia në përgjithësi dhe çështja kombëtare dhe Kosova në veçanti. Kjo është sfera mitike, sipas të cilës, i vetmi opsion i

drejtë është bashkimi. Është e qartë se në këtë sferë, bota mitike brenda saj nuk është aspak demokratike.

Sfera tjetër është sfera e marrëdhënieve të përditshme midis dy shteteve, marrëdhëniet midis dy qeverive dhe institucioneve shtetërore respektive, komunikimet dhe bashkëveprimi i dy shoqërive, marrëdhëniet dhe shkëmbimet ekonomike, kulturore, shkencore, marrëdhëniet njerëzore, debatet dhe pasqyrimet e tyre. Kjo është sfera reale e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës. Madje edhe sfera mitike është pjesë e kësaj sfere.

Ndryshe nga sfera mitike, që është totalitare për nga karakteri, sfera reale është “demokratike”, gjithë reliev, mjaft e diskutueshme dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Sfera mitike dhe sfera reale operojnë dhe funksionojnë paralelisht, por ato gjithashtu bashkëveprojnë me njëra-tjetrën duke influencuar njëra-tjetrën dhe zhvillimet brenda tyre. Herë-herë ndërveprimi ndërmjet tyre është aq i madh, sa nuk ka një kufi të qartë ndarës midis botës mitike dhe asaj reale. Kjo duket se ndodh edhe për faktin se personazhet, protagonistët, lojtarët janë të njëjtët: shtetarë, politikanë të të gjithë spektrit, por edhe populistët, nacionalistët, patriotët (dhe afërmendsh sharlatanët) nga të gjitha llojet e mësipërme.

Shqyrtimi kritik i zhvillimeve brenda-përbrenda secilës sferë, si edhe shqyrtimet e zhvillimeve në ndërvarësinë e këtyre dy sferave është i domosdoshëm për të kuptuar, shpjeguar dhe për t’ju dhënë përgjigje pyetjeve: A është i dëshirueshëm, i domosdoshëm dhe i dobishëm bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës në një shtet të vetëm? A është i mundshëm dhe i lejueshëm ky bashkim nga pikëpamja e ligjit themelor të shtetit, kushtetutës,

të drejtës ndërkombëtare si dhe konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar ose pritet të nënshkruajë në të ardhmen? E fundit, por jo e fundit për nga rëndësia, në rastin e një bashkimi eventual, cilat do të ishin implikimet politike, social-ekonomike, fetare dhe në fushën e sigurisë, së pari, në Shqipëri dhe në shtetin që do të ishte produkt i këtij bashkimi, dhe së dyti, implikimet në rajonin e Ballkanit?

Mbështetje popullore për bashkimin: mirë se vini në botën mitike

Më shumë se njëqind vjet pas themelimit dhe njohjes së Shqipërisë si shtet i pavarur, tridhjetë vjet pas fillimit të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe dymbëdhjetë vjet pas shpalljes dhe njohjes së Kosovës si shtet i pavarur, ideja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë zë një vend të rëndësishëm, jo vetëm në narrativët populiste/nacionaliste brenda dhe jashtë Shqipërisë, por edhe në një shkallë të gjerë edhe në perceptimet e të gjithë shoqërisë. Për të gjitha segmentet nacionaliste ose jo, populiste ose jopopuliste, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë do të shënonte zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare për të cilën të gjithë flasin me të njëjtat terma si më 1913, më 1990 apo në vitin 2008, duke injoruar të gjithë trajektoren historike përfshirë edhe faktin se prej vitit 2008, Kosova është një shtet i pavarur dhe jo një ish-territor që duhet t'i bashkohet “vendit amë”.

Në perceptimet e qytetarëve shqiptarë, ideja e bashkimit të Shqipërisë dhe Kosovës duket të jetë mjaft popullore. Kështu në rastin e një referendumi, një shumicë e madhe, deri në 75%,⁴² e qytetarëve në Republikën e Shqipërisë do të votonin për bash-

kimin e Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo është një mbështetje gati popullore për *bashkimin kombëtar* dhe nëse vijojmë të “shëtisim” në botën e perceptimeve ose në sferën apo botën mitike të ideve për të tashmen dhe sidomos ideve, koncepteve dhe pritshmërive për të ardhmen e Shqipërisë dhe Kosovës, do të evidentojmë të dhëna të tjera, të cilat gjithashtu konfirmojnë se mbështetja për bashkim është popullore dhe madje kjo mbështetje është në rritje. Kështu, në vitin 2012, mbështetja për bashkimin e të dy shteteve në një shtet të përbashkët ishte 62 për qind. Në vitin 2010, vetëm 9 për qind e qytetarëve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë e shikonin bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të vetëm si diçka pozitive.⁴³ Mirëpo, pas pothuajse një dekade, numri i atyre që e shikojnë bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë si diçka pozitive është gati shtatëfishuar duke mbërritur në 58%.

Gjate katër pesë viteve të fundit shumica e qytetarëve në Shqipëri, 84 për qind prej tyre, mendojnë se marrëdhëniet midis të dy vendeve janë të mira ose shumë të mira. Po kështu, një shumicë dërrmuese prej 87 për qind, besojnë se në të ardhmen marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës do të thellohen dhe vendet do të afrohen akoma më shumë.⁴⁴

Mirëpo dy të dhënat e fundit, që tregojnë perceptimin e qytetarëve për gjendjen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe bashkëpunimin aktual, si dhe optimizmi i madh që qytetarët perceptojnë për të ardhmen e këtij bashkëpunimi, sugjerojnë se për të kuptuar dhe shpjeguar natyrën e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, nivelin e bashkëpunimit dhe prospektet për të ardhmen, nuk janë të mjaftueshme vetëm të dhënat, që vijnë nga sfera mitike, por është e domosdoshme dalja nga kjo sferë dhe ballafaqimi me atë çfarë ndodh në botën reale.

Marrëdhënie të varfra, tensione në rritje

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës kanë shënuar një përparim mbresëlënës. Të dy shtetet duken të angazhuara për të rritur bashkëpunimin ndër-shtetëror ndërsa nuk ekzistojnë dhe natyrisht nuk ka se si të ekzistojnë mosmarrëveshje për territore, kufirin, minoritetet apo çështje të ngjashme të cilat janë tipike për dy shtete fqinje, çështje të cilat i çojnë fqinjët përgjithësisht drejt konflikteve.

Përparimi në fushën ekonomike gjithashtu nuk ka munguar. Brenda pesë vjetëve të parë nga shpallja e pavarësisë, vëllimi i përgjithshëm tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës mbërriti në 160⁴⁵ milionë Euro ndërsa vitin e kaluar (2019) shkëmbimet arritën në 306 milionë Euro.⁴⁶

Gjithsesi, janë një numër faktorësh që nuk i bëjnë të lehta marrëdhëniet midis dy vendeve, në mënyrë të veçantë kur është fjala për bashkëpunimin ekonomik. Së pari, Shqipëria dhe Kosova nuk po e rizbulojnë njëra-tjetrën, nuk po rivendosin një bashkëpunim ekonomik të ndëprerë por po krijojnë një realitet të ri bashkëpunimi.

Së dyti, për të gjitha shtetet e tjera ballkanike, bashkëpunimi ekonomik pas shpërbërjes së Jugosllavisë në njëfarë mënyre është *back to the future* përmes shfaqjes së asaj që Tim Judah e emërton si *yougosphere*⁴⁷. Të dy këta faktorë shpjegojnë pse marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës që janë dy shtete që i përkasin një kombi, nuk mund të jenë më konkurruese sesa marrëdhëniet dypalëshe midis ish anëtarëve të Federatës, përfshirë edhe ato të Kosovës me ish republikat e tjera.

Së treti, strukturat e ekonomive në Shqipëri dhe në Kosovë kanë qenë të dominuara nga ekonomia agrare dhe historikisht kanë synuar mbijetesën e popullsisë. Niveli i industrializimit, në fakt jo i pangjashëm me vendet e tjera ballkanike, edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, megjithë përparimet, mbetet i ulët dhe po kështu niveli i integritit në ekonominë europiane apo globale.

Së katërti, tregu dhe ekonomia e Shqipërisë është orientuar kryesisht në drejtim të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, Italisë dhe Greqisë.

Megjithë përparimet dhe një tendencë rritjeje, marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës mbeten përgjithësisht të varfra.⁴⁸

Qysh nga viti 2008 marrëdhëniet politike dhe bashkëpunimi ndërshtetëror midis Shqipërisë dhe Kosovës është më shumë protokollar, ceremonial, se sa përmbajtësor,⁴⁹ sepse ka shumë folklorizëm, formalitete dhe pak përmbajtje.⁵⁰

Aktualisht marrëdhëniet janë nën nivelet standarde të dy shteteve fqinje⁵¹. Mungojnë planifikimet dhe idetë strategjike,⁵² si dhe nuk ka ndonjë vizion të përbashkët ose strategji të harmonizuar midis të dy vendeve⁵³. Bashkëpunimi dhe shkëmbimet akademike midis institucioneve akademike dhe qendrave kërkimore të Shqipërisë dhe Kosovës janë sporadike. Por ajo që është më e papranueshme dhe e pashpjegueshme është se niveli aktual i bashkëpunimit dhe shkëmbimeve akademike është më i ulët se sa niveli i bashkëpunimit në vitet shtatëdhjetë, periudhë gjatë të cilës shkëmbimet mes Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës morën një hov të madh.⁵⁴

Është e vërtetë se të dy shoqëritë kanë aktualisht një komuni-

kim më të madh që vjen nga hapja e të dy vendeve dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore. “Rruga e Kombit”, autostrada që lidh prej më shumë se një dekade Shqipërinë dhe Kosovën ka gjallëruar shumë komunikimin dhe bashkëpunimin.

Falë zhvillimeve teknologjike, internetit e rrjeteve sociale bashkëpunimin midis dy shteteve ka një ndërvarësi në rritje. Megjithatë mediat tradicionale dhe tregu i tyre zhvillohen të pavarura. Aktualisht asnjë gazetë e Shqipërisë nuk është e pranishme në tregun e Kosovës dhe anasjelltas, duke përjashtuar programet kulturore të televizioneve, kryesisht të Shqipërisë, që janë më prezentë në Kosovë. Nuk ka dyshim se shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë kanë një hapësirë komunikimi në rritje, por kjo nuk është meritë e qeverive në Tiranë apo në Prishtinë.⁵⁵

Ekzistojnë një numër i madh marrëveshjesh të nënshkruara midis dy shteteve, por shumica e tyre u ngjajnë protokolleve dhe memorandumëve të bashkëpunimit, në të cilat thjesht palët bien dakord në parim për të bashkëpunuar. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh nuk janë zbatuar dhe të dy qeveritë së fundi janë angazhuar të ngrenë një komision ndërqeveritar për të diskutuar pikërisht nivelin e ulët ose moszbatimin e plotë të marrëveshjeve të nënshkruara. Në shumicën e këtyre marrëveshjeve mungojnë instrumentet, afatet dhe detyrimet e secilës palë, që do t'i bënte këto marrëveshje të aplikueshme dhe të dobishme.

Gjatë katër-pesë vjetëve të fundit, të dy qeveritë organizojnë mbledhje të përbashkëta, pompoze, me skenografi plot ngjyra dhe simbole kombëtare, që do t'i kishin zili të gjithë nacionalistët dhe populistët në të dy anët e kufirit,⁵⁶ por praktikisht midis të dy vendeve ekzistojnë barriera serioze që ngadalësojnë bashkëpunimin ekonomik dhe shkëmbimet tregtare. Aktualisht

investimet reciproke te kapitalit mbeten ende të papërfillshme, ndërsa në fusha si energjia, shërbimet bankare, telekomunikacioni, bashkëpunimi bilateral është ende rudimentar, ndonëse në këta sektorë ka avantazhe mjaft më të mëdha.⁵⁷

Përveç mungesës së përparimit dhe forcimit të marrëdhënieve apo gjendjes së *status-quo*-së në të cilën kanë mbërritur marrëdhëniet dypalëshe, marrëdhëniet aktuale midis Shqipërisë dhe Kosovës nuk janë të lira nga tensionet, të cilat herë-herë shoqërohen me polemika të ndërsjellta.⁵⁸

Fasadat e mëdha, plot ngjyra, të zbukuruara me simbole kombëtare, nuk e fshehin dot më që midis Shqipërisë dhe Kosovës ka një tension në rritje. Burimet e këtyre tensioneve dhe mosmarrëveshjeve janë të ndryshme. Burimi i parë i tensioneve është i natyrës ekonomike dhe lidhet kryesisht me shkëmbimet tregtare. Hera-herës, në kufirin midis Shqipërisë dhe Kosovës, i cili është një kufi që ndan një komb, shpërthejnë “luftëra” të vockla për tregtinë e miellit, të patateve apo qumështit. Pavarësisht fasadës së marrëdhënieve të shkëlqyera, duket se të dy vendet “hezitojnë” të shmangin pengesat që do të lehtësonin shkëmbimet tregtare midis dy vendeve për të mos përmendur, që nuk bëhet fjalë për të aplikuar instrumente të reja më favorizuese. Në të dy vendet ekonomia kontrollohet nga rrjete oligarkësh, të lidhur me pushtetin, të cilët kontrollojnë dhe orientojnë bashkëpunimin.⁵⁹

Në qershor të vitit 2019, Qeveria e Kosovës kërcënoi për të vendosur si me Serbinë, taksën 100 për qind për eksportet shqiptare, nëse Shqipëria nuk merrte masa për të hequr barrierat ekzistuese.⁶⁰

Ndërsa duke pranuar që në bashkëpunimin ekonomik mund të ishte arritur diçka më shumë se sa deri më sot, nuk duhet

që të konkludojmë me naivitet se një shkëmbim më intensiv ekonomik mes dy vendeve do të kishte ndikim të fortë në rritjen e ekonomive respektive të të dy shteteve. Pavarësisht shkallës së ndryshme të zhvillimit, ekonomia shqiptare dhe ajo kosovare janë ekonomi të vogla, të pa modernizuara, me nivel të ulët të prodhimit industrial e të shërbimeve, me institucione tregu të brishta e pse jo edhe të deformuara.⁶¹

Gjithsesi tensionet me burime çështjet ekonomike janë të një profili më të ulët dhe rrallë marrin vëmendjen dhe angazhimin e qeverisë apo institucioneve politike të Kosovës. Tensionet në rritje dhe mosmarrëveshje serioze midis Shqipërisë dhe Kosovës janë në fakt të karakterit politik dhe janë të lidhura me marrëdhëniet e Shqipërisë me Serbinë, që reflektojnë një tendencë për një qasje paternalizmi⁶² në rritje dhe konsistente të Shqipërisë kundrejt Kosovës.

Kështu, më 2016, pas tensioneve politike, që shoqëruan iniciativën e Shqipërisë, për të udhëhequr, bashke me Serbinë, pajtimin midis shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan, tensionet dhe mosmarrëveshjet u rikthyen përsëri gjatë vitit 2018 dhe sidomos në gjysmën e dytë të vitit 2019. Edhe më 2018, si edhe në fundin e vitit 2019, burimet e tensionit ishin përsëri “axhenda strategjike” e Shqipërisë dhe Serbisë: krijimi i paqes në Ballkan, çështja e pajtimit të shqiptarëve dhe serbëve “e ardhmja europiane e të gjithë rajonit” dhe sigurisht “e ardhmja e Kosovës”.⁶³

Në vitin 2018 duket se Kryeministri i Shqipërisë mbështeste në mënyrë aktive arritjen e një marrëveshje midis Serbisë dhe Kosovës,⁶⁴ marrëveshje që parashikonte shkëmbim të territoreve ose ‘korrektim të kufijve’, sikundër Aleksander Vuçiç e paraqiste këtë iniciativë. Një marrëveshje e tillë, termat e të cilës nuk

u bënë publike kurrë, nuk gjeti mbështetjen e udhëheqësve të tjerë politikë në Kosovë, thelloi jo vetëm mosmarrëveshjet midis Presidentit Thaçi dhe udhëheqësve të tjerë të Kosovës, por riktheu edhe një gjendje të tensionuar me Tiranën. Prishtina politike dukej se nuk e aprovonte protagonizmin e kryeministrit shqiptar në një çështje që i takonte ekskluzivisht Kosovës dhe institucioneve të saj .

Fuqitë europiane mbajtën qëndrime të ndryshme, duke përjashtuar Gjermaninë, e cila nuk e mbështeste arritjen e një marrëveshjeje Serbi-Kosovë përmes shkëmbimit të territoreve/korrigjimit të kufijve në Ballkan, ndërsa dukej se Uashingtoni ishte i gatshëm të mbështeste zgjidhjen e konfliktit të ngrirë midis Serbisë dhe Kosovës qoftë edhe me një marrëveshje që do të korrigjonte kufijtë, por që do të pranohej nga të dy shtetet.⁶⁵ Sipas Këshilltarit të Sigurisë Kombëtare, John Bolton, SHBA ishte e hapur për një shkëmbim territorësh midis Kosovës dhe Serbisë si pjesë e një marrëveshjeje që do të normalizonte marrëdhënjet midis dy ish armiqëve⁶⁶

Mbështetësit perëndimorë, si SHBA, por edhe shtete të tjera, të një marrëveshjeje paqeje midis Serbisë dhe Kosovës qoftë edhe përmes ndryshimit të kufijve⁶⁷ dukej se e mbivlerësonin rolin që Shqipëria dhe posaçërisht Kryeministri i Shqipërisë mund të luante që “ta bindte Kosovën” për të pranuar marrëveshjen. Nga ana tjetër, megjithëse Prishtina, në mënyrë konstante, nuk e ka aprovuar asnjëherë paternalizmin dhe protagonizmin e Tiranës në çështje themelore të vetat e në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet e saj me Serbinë apo për çështje të ngjashme, Kryeministri i Shqipërisë u investua në favor të marrëveshjes Serbi-Kosovë gati në rolin e protagonistit, duke qenë

konsistent në përpjekjet për tu projektuar si një udhëheqës me ndikim në të gjithë shqiptarët e Ballkanit. Përforcimit të idesë së lidhshimit në hapësirat shqiptare në Ballkan, pavarësisht se këto hapësira aktualisht ndahen në shtete të pavarura, duket se i shërbyen edhe dy propozime të Kryeministrit të Shqipërisë: i pari në shkurt të vitit 2018, kur ai i propozoi Parlamentit të Kosovës që Shqipëria dhe Kosova të kishin një President të përbashkët si simbol të bashkimit kombëtar dhe vendimi i dytë, me emërimin në postin e ministrit të jashtëm⁶⁸ të Shqipërisë të një të riu nga Kosova.⁶⁹

Tensionet politike u rikthyen sërish në gjysmën e dytë të vitit 2019 për shkak të iniciativës së përbashkët të Beogradit dhe Tiranës për Shengenin Ballkanik,⁷⁰ pjesëmarrjen në të cilin Kosova e ka refuzuar në mënyrë kategorike dhe me konsensus të plotë të qeverisë, presidentit dhe të gjitha partive politike, përfshirë edhe Lëvizjen *Vetvendosja* që kishte dalë partia e parë në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit 2019 dhe supozohej se do të udhëhiqte një kabinet në koalicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës.⁷¹

Pakënaqësia dhe tensionet në nivelin politik kanë të bëjnë me faktin se edhe Serbia - në mënyrë paradoksale, edhe Shqipëria - vijnë ta mbajnë Kosovën në axhendën e tyre bilaterale. Kosova nuk dëshiron që Shqipëria të flasë në emër të saj dhe nuk i njeh Tiranës ndonjë mandat që kjo e fundit të negociojë me Serbinë në emër të Kosovës. Po kështu, Kosova nuk dëshiron që Shqipëria të ketë një rol ndërmjetësues në marrëdhëniet e saj me Serbinë.⁷² Qeveria e Republikës së Kosovës duket se i shikon me rezerva përpjekjet e Shqipërisë për të udhëhequr procesin e pajtimit të shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan sipas modelit franko-gjerman.⁷³ Sipas Qeverisë së Kosovës, pajtimi

i shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan kalon përmes Prishtinës dhe jo përmes Tiranës.⁷⁴

Ky ballafaqim i marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës me botën reale ngre pikëpyetje serioze për botën *mitike* të perceptimeve, ku e tashmja është e shkëlqyer dhe e ardhmja edhe më e ndritshme. Do të ishte spekulative që për analogji të mbërrinim në të njëjtin konkluzion edhe për sa i përket idesë popullore për bashkim. Megjithëkëtë, ballafaqimi me “botën reale” për sa u takon marrëdhënieve aktuale midis dy vendeve të paktën sugjeron fort shqyrtimin kritik të mbështetjes së madhe që ka ideja e bashkimit në perceptimet e njerëzve.

Nëse e përfytyrojmë sferën e perceptimeve, pra, botën mitike dhe botën reale të marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, si dy rrahë që nuk përputhen me njëri-tjetrin, të dy botët gjithsesi kanë një pjesë të përbashkët. Sa më e vogël të jetë kjo pjesë, aq më e madhe është diferenca midis dy sferave dhe aq më të ndryshme janë dy botët respektive: ajo imagjinare dhe ajo reale. Dhe sigurisht e kundërta: sa më e madhe të jetë pjesa e përbashkët e këtyre, aq më shumë i ngjajnë njëra-tjetrës bota mitike dhe ajo reale. Ndërkohë, ekzaminimi i kujdesshëm i pjesës së përbashkët na ndihmon për të verifikuar çështje themelore, siç është, për shembull, ideja e bashkimit të dy shteteve dhe përmasat reale të kësaj mbështetjeje. Kështu, pavarësisht se 75 për qind e qytetarëve në Republikën e Shqipërisë do të votonin pro bashkimit në një referendum potencial, ky bashkim është i dëshirueshëm vetëm për 63 për qind.⁷⁵ *Mbështetja popullore* për bashkimin zvogëlohet edhe më shumë, nëse i referohemi një të dhëne tjetër që vjen po nga bota e perceptimeve: qytetarët në Shqipëri janë më skeptikë sa i përket votës ‘pro’ bashkimit, duke pohuar se

familjarët, shokët dhe miqtë do të votonin në shkallë më të ulët për bashkimin (59% në Shqipëri dhe 47% në Kosovë).⁷⁶

Një ballafaqim i perceptimeve, që kanë për idenë e bashkimit të dy shoqëritë në Shqipëri dhe në Republikën e Kosovës, sugjeron gjithashtu idenë e daljes nga sfera mitike. Historikisht, ideja e bashkimit kombëtar ka qenë shumë më e pranishme dhe më e fortë dhe më e përhapur në Kosovë se sa në Shqipëri për vetë faktin se Shqipëria është parë si *vendi amë*, megjithëse këtë rol nuk e ka luajtur ndonjëherë dhe udhëheqësit e Kosovës kanë kërkuar formalisht bashkimin me Shqipërinë.

Gjithashtu, edhe perceptimi se ideja e bashkimit është më e përhapur dhe më e përçafuar në Kosovë ka qenë po kështu dominues.

Në vitin 2010 mbështetja për bashkim kombëtar ka qenë spektakolare në Kosovë me 81 për qind që do të votonin ‘pro’ këtij bashkimi në rastin e një referendumi. Në Shqipëri gjithmonë është besuar se ideja e bashkimit është shumë më e gjallë në Kosovë se sa në Shqipëri.⁷⁷ Aktualisht është befasuese të konstatohet se kjo përkrahje ka ndryshuar, madje është përmbytur: Në Shqipëri për bashkimin do të votonin 75 për qind e shqiptarëve përkundër 64 për qind në Kosovë.⁷⁸ Më tej, duket se është edhe e diskutueshme, nëse iu referohemi perceptimeve që kanë për njëra-tjetrën të dy shoqëritë, kur është fjala për bashkimin. Ndërsa në Shqipëri besohet se çështja e bashkimit është më e pranishme atje-⁷⁹ në Kosovë perceptimi është se dëshira për bashkim kombëtar është e njëanshme dhe është e shprehur vetëm prej kosovarëve, por jo edhe atje prej popullit të Shqipërisë.⁸⁰

Nëse lëvizim prej sferës së perceptimeve në drejtim të pjesës së përbashkët të të dy sferave mund të konstatojmë se *mbështetja shumë popullore* për bashkimin e të dy shteteve bie. Është mjaft domethënës dhe i rëndësishëm fakti që vetëm 47 për qind e të rinjve shqiptarë mbështesin idenë e bashkimit kombëtar dhe në mënyrë të barabartë 47 për qind të tjerë mbështesin zhvillimin e marrëdhënieve normale midis dy shteteve të pavarura.⁸¹ Më tej, nëse konsiderojmë se vetëm 29 për qind e qytetarëve në Republikën e Shqipërisë janë të gatshëm të paguajnë një taksë që do të mundësonte bashkimin kombëtar afërmendsh që kemi hyrë në sferën/botën reale përkundër asaj imagjinare ku 75 për qind dëshironin bashkimin.

Pas këtij “udhëtimi” nga sfera e perceptimeve te pjesa e përbashkët, më në fund mund të “mbërrijmë” në sferën reale: vetëm 23%⁸² e qytetarëve në Republikën e Shqipërisë besojnë se bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të vetëm është i mundshëm. Në fund të fundit, përse të mos shfaqemi “korrekt politikisht” duke “votuar” pro bashkimit kombëtar, kur e dimë se shanset për të ndodhur ky bashkim janë shumë të pakta?!

Bashkimi si dogmë dhe si realitet

Dhjetë vjet më parë, vetëm 39 për qind e qytetarëve në Republikën e Shqipërisë do të votonin pro bashkimit kombëtar në një referendum potencial⁸³. Për një kohë relativisht të gjatë, çështja e Kosovës dhe përgjithësisht çështja kombëtare perceptohej dhe pretendohej si një monopol i partive politike të djathta apo të qendrës së djathtë dhe sidomos jo e të majtëve dhe Partisë Socialiste, në veçanti, si trashëgimtare e Partisë Komu-

niste. Një konceptim i tillë e kishte origjinën në Luftën e Dytë Botërore, ku një nga çështjet që i ndau fort forcat nacionaliste dhe Partinë Komuniste ishin mosmarrëveshjet për të ardhmen e Kosovës, për të cilën forcat e djathta nacionaliste kërkonin bashkimin e menjëhershëm ndërsa komunistët e Enver Hoxhës këmbëngulnin për zgjidhjen e çështjes me bisedime pas luftës.⁸⁴

Por gjërat kanë ndryshuar. Aktualisht, për *bashkimin* në Republikën e Shqipërisë do të votonin 75 për qind e qytetarëve në rastin e referendumit dhe partitë e djathta tradicionale ose ato që u krijuan në fillim të viteve nëntëdhjetë, pothuajse e kanë humbur monopolin mbi çështjen kombëtare dhe çështjen e Kosovës në veçanti. Tani të gjitha partitë politike flasin për çështjen kombëtare, për bashkimin kombëtar dhe në luftën dhe konfliktin e tyre të përhershëm politik janë në përgjim se kush po e *tradhton* çështjen kombëtare.

Në Kosovë, nën një regjim të ashpër, diskriminues dhe relativisht shtypës, në Jugosllavinë e Titos, shqiptarët dhe udhëheqësit e tyre të djathtë apo të majtë, sidomos të majtë, e kishin idealizuar në ekstrem “*atdheun mëmë*” dhe mbështesnin idenë e bashkimit. Por dymbëdhjetë vjet pas pavarësisë, shoqëria kosovare dhe udhëheqësit e saj duket se janë duke dalë nga ai *rrafsh romantik* duke e parë gjithmonë e më me skepticizëm idenë e bashkimit dhe gjithmonë e më shumë realizëm marrëdhëniet me ish-vendin amë, Shqipërinë. E kundërta duket se po ndodh në Shqipëri, ku çështja e bashkimit kombëtar nga një mit është duke u shndërruar në një dogmë e cila shpallet e shenjtë dhe për të cilën nuk mund të ngrihen pikëpyetje.⁸⁵

Në Shqipëri, në narrativin aktual për bashkimin kombëtar,

gjithmonë e më shumë po neglizhohet argumenti themelor për këtë bashkim, argumenti i pamundësisë që Shqipëria të jetë një shtet i fortë dhe funksional pa qenë i bashkuar me Kosovën.

I vetmi argument brenda narrativit të bashkimit, që ruhet me fanatizëm dhe për të cilin nuk ka nevojë të debatohet, është ai *i padrejtësisë historike*, që duhet të korrigjohet. Kësisoj ligjërimi është totalitar, në të cilin është e vështirë të sillen argumente të reja për domosdoshmërinë e bashkimit dhe aq më pak të propozohen politika apo instrumente, që mund të çojnë drejt një bashkimi eventual. Arsyeja e vetme e bjerrjes së argumentit të qëndrueshmërisë lidhet me tendencën për ta mbajtur debatin në të shkuarën. Kjo qasje mban larg debatin për funksionalitetin e shtetit sot, për ekonominë dhe zhvillimin e shoqërisë. Më 1913, argumenti i të qenit jo një shtet i funksional pa Kosovën ishte i qëndrueshëm, i arsyetuar dhe i mbështetur. Në rrethanat e sotme është e vështirë të shpjegosh dhe arsyetosh se Shqipëria është një shtet i dobët, nëse jo i dështuar, me argumentin se bashkimi kombëtar nuk është realizuar, trojet shqiptare janë të copëtuara dhe sidomos Kosova nuk është e bashkuar me Shqipërinë.

Nga ana tjetër, megjithëse shoqëria kosovare dhe udhëheqësit e saj kanë një qasje më realiste për çështjen e bashkimit, gjithsesi, krahas argumentit të bashkimit për të korrigjuar *një padrejtësi historike*, është i gjallë edhe argumenti i bashkimit kombëtar si një domosdoshmëri që shteti të jetë i shëndetshëm dhe funksionues. Gjatë dhjetë vjetëve të fundit kjo ka qenë një tezë themelore e programit politik të Lëvizjes Vetëvendosje, të udhëhequr nga Albin Kurti. Sipas tij, Kosova dhe Shqipëria nuk janë shtete funksionuese, sepse janë të ndara dhe vetëm bashkimi do të çonte në një shtet të qëndrueshëm dhe funksionues.⁸⁶

Mund të tingëllojë cinike, por sipas këtij argumenti, me fitoren në zgjedhjet më të fundit parlamentare (6 tetor 2019) dhe ardhjen në pushtet të Vetëvendosjes së Albin Kurtit, qytetarët në Republikën e Kosovës duhet të presin të realizohet bashkimi kombëtar në mënyrë që shteti të jetë funksionues dhe të sigurojë të mirat publike bazë: drejtësi, arsimim dhe shëndetësi me standarde të larta, siguri, infrastrukturë të zhvilluar, mundësi të barabarta për të investuar dhe zhvilluar kapitale etj.

Duket se edhe në Kosovë çështja e bashkimit po ndjek të njëjtën trajektore si në Shqipëri: nga mitizimi te dogma. Megjithëkëtë, duhet të pritët për t'u parë nëse një parti e rëndësishme në Kosovë si Vetëvendosja, e cila në opozitë e kishte shpallur bashkimin kombëtar si një *sine qua non* për një shtet funksionues, demokratik, të zhvilluar, do të aplikojë një qasje të ngjashme me atë që kanë aplikuar partitë politike në Republikën e Shqipërisë.

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, në Shqipëri, të gjithë ishin në garë të ethshme për të mbështetur dhe zgjidhur çështjen kombëtare: partitë politike, organizatat e pavarura, akademja e shkencave, organizatat e shoqërisë civile, shtypi dhe media. Çështja kombëtare dhe zgjidhja e saj hapte programet e partive apo organizatave të tjera politike. Në fjalimin e parë publik të kryetarit të Partisë Demokratike, partisë së parë opozitare në Shqipëri, në dhjetor 1990, Kosova dhe bashkimi kombëtar zinte vend qendror. Udhëheqësi i opozitës u tha të gjithë shqiptarëve se “Partia Demokratike e Shqipërisë nuk mund ta pranojë ndarjen e kombit shqiptar si të përjetshme.⁸⁷ Mirëpo gjatë një trajektoreje prej tri dekadash, narrativi rreth çështjes kombëtare dhe posaçërisht çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë ka kaluar në tri faza të ndryshme: Rënia e Komunizmit, më 1990,

shënon rikthimin e çështjes së bashkimit kombëtar me narrativët thellësisht nacionaliste. Pas kësaj, një qasje realiste shënon fazën e dytë, që përkon me periudhën më të vështirë të tranzicionit postkomunist. Në narrativin për Kosovën dhe përgjithësisht të çështjes kombëtare bie ideja e bashkimit.

Forcat demokratike, që erdhën në pushtet vijonin të mbështesnin parimin e vetëvendosjes për shqiptarët në Kosovë dhe në të njëjtën kohë përpiqeshin të siguronin Perëndimin se Shqipëria nuk kishte pretendime territoriale dhe se e kundërshtonte ndryshimin e kufijve. Tirana përpiqej të bindte udhëheqësit e Prishtinës të hiqnin dorë nga shpresat për krijimin e një shteti të pavarur apo për bashkimin me Shqipërinë.⁸⁸ Madje më 1997, në Samitin e Selanikut, një vit përpara se të shpërthente lufta në Kosovë, Kryeministri i Shqipërisë i kërkoi Millosheviçit të zbatonte marrëveshjen e arsimit që ky kishte nënshkruar me Ibrahim Rugovën.⁸⁹ Nënteksti ishte i qartë: Kosova ishte një çështje e brendshme e Serbisë dhe mosmarrëveshjet midis Beogradit dhe Prishtinës kishin të bënin me çështje teknike, siç është arsimimi. Kur u pa qartë se Serbia dhe Kosova nuk mund të kishin një të ardhme të përbashkët, Tirana mbështeti fort opsionin e pavarësisë.

Në dekadën e fundit, e cila shënon fazën e tretë, narrativi rreth çështjes së bashkimit është shndërruar në një dogmë. Prej kohësh nuk ka më një qasje kritike për idenë e bashkimit, nuk ka më pyetje përse Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë, a dëshirojnë udhëheqësit politikë, shoqëritë që dy shtetet të bashkohen; a është i mundshëm bashkimi dhe çfarë implikimesh mund të ketë një bashkim eventual? A do të ishte më i fortë, më funksionues, më demokratik, shteti që do të krijohet nga bashkimi i të dy shteteve aktualisht të dy të dobët dhe hera-herës fare pranë dështimit?

Duket se shumica e shqiptarëve në Shqipëri dhe në Kosovë e pranojnë bashkimin pa ngritur asnjë dyshim, asnjë pyetje. Por aktualisht, shqiptarët në të dyja anët e kufirit nuk kanë një ide të qartë se çfarë bashkimi dëshirojnë dhe se si duhet të arrihet ky bashkim. Vetë ideja e bashkimit është një ide abstrakte,⁹⁰ që gjithmonë e më shumë po shndërrohet në një dogmë, e cila në rastin e Kosovës bëhet edhe më e qartë, duke qenë edhe kontraversiale, nëse jo absurde. Për shembull, nëse në Kosovë për bashkimin do të votonin 64 për qind e qytetarëve, a do të thotë se kjo shumicë është kundër sovranitetit dhe pavarësisë së Kosovës? A është kjo shumicë kundër ekzistencës së Kosovës si shtet i pavarur, sepse edhe të bashkohesh me Shqipërinë, edhe të ruash sovranitetin e Kosovës, nuk është e mundshme as teorikisht. Teorikisht ka vetëm një mundësi të vetme që Kosova të bashkohet me Shqipërinë dhe të ruajë edhe sovranitetin dhe pavarësinë e saj. Dhe kjo mundësi është që Kosova ta aneksonte Republikën e Shqipërisë,⁹¹ gjë që është e vështirë të besohet se qytetarët e Shqipërisë apo udhëheqësit e saj politikë do të ishin të gatshëm, përfshirë edhe NATO-n, ku Shqipëria është anëtare prej vitit 2009.

Në Shqipëri dogma e bashkimit po bëhet gjithmonë e më popullore nëse konsiderojmë se aktualisht 75 për qind e qytetarëve në Republikën e Shqipërisë do të votonin *pro* në rastin e një referendumi.

Megjithëkëtë, do të ishte e pakta naive nëse këtë mbështetje të dogmës do ta interpretonim si mbështetje reale për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën. Një ekzaminim i kujdesshëm i programeve politike të partive, të paktën të atyre që kanë ose kanë pasur përfaqësuesit e tyre në parlament, tregon se për çështjen kombëtare flitet me një gjuhë shumë të përgjithshme, kontradik-

tore, gjithë ekuivoke, në të cilën shprehen interesat dhe synimet e integriteteve dhe realizimit të aspiratave kombëtare njëkohësisht, por në asnjërin prej këtyre programeve nuk flitet për idenë e bashkimit të Shqipërisë me Kosovën në një shtet të vetëm.⁹²

Çështja e bashkimit të dy shteteve nuk ka qenë prej kohësh pjesë e fushatave elektorale të partive politike në Shqipëri. Është e vështirë të besohet se një çështje, që teknikisht gëzon një legjitimitet dhe popullaritet të madh të mos bëhet pjesë e fushatave zgjedhore. Nëse çështja e bashkimit kombëtar është kaq e rëndësishme për qytetarët, përse asnjëra prej partive kryesore në Shqipëri nuk e kanë mbështetur këtë tezë? Jo vetëm partitë kryesore, por asnjë parti politike me influencë, qoftë edhe minimale në Shqipëri, nuk e mbështet këtë tezë. E vetmja parti politike ishte Aleanca Kuq e Zi, që shpalli si objektiv themelor të saj bashkimin kombëtar, por që në zgjedhjet e vitit 2013 mori më pak se një për qind të votave.⁹³

Ky tingëllon si një paradoks i madh: Nga njëra anë çështja e bashkimit duket se gëzon mbështetje popullore (75 për qind), kurse, nga ana tjetër, çështja e bashkimit të dy shteteve nuk zë vend në programet politike të partive, ajo nuk është çështje e debatit dhe fushatave zgjedhore dhe asnjë prej partive politike me influencë nuk ka shpallur bashkimin në objektivat e veta politike. Së fundi, por jo e fundit për nga rëndësia: bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk është një ndër dhjetë problemet më shqetësuese që kanë qytetarët shqiptarë⁹⁴ dhe pavarësisht këtyre të gjithave, shumica dërrmuese do të votojnë pro bashkimit. Kundërshtarët e vetëm të këtij bashkimi, nëse mund të konsiderohen të tillë, janë një grup politikanësh për të cilët bashkimi i Kosovës me Shqipërinë është i rëndësishëm dhe ai do të ndodhë në Bashkimin Europian,⁹⁵ kur të gjithë e dimë që Bashkimi Europian është

një 'klub', anëtarët e të cilit pavarësisht se kanë pranuar të dorëzojnë diçka nga sovraniteti i tyre në Bruksel, mbeten gjithsesi shtete të pavarura. Bashkimi i Shqipërisë me Kosovën në një shtet të vetëm brenda Bashkimit Europian, është aq i mundshëm sa çka qenë bashkimi i Gjermanisë me Austrinë.

Degjenerimi i marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës në një dogmë për bashkimin e tyre në një shtet të vetëm, që do të zgjidhte edhe çështjen kombëtare shqiptare përmban tre rreziqe:

Së pari, fsheh marrëdhëniet e varfra dhe akumulimin e tensioneve në rritje, që mund të çonin edhe në konflikte eventuale, në vend që të dy shtetet të angazhoheshin seriozisht për të rritur bashkëpunimin reciprok në të gjitha fushat, nga i cili do të përfitonin qytetarët e të dy shteteve.

Së dyti, kjo dogmë ushqen tezën se Shqipëria kërkon rivenidikimin e kufijve në Ballkan në funksion të zgjerimit të shtetit të vet dhe krijimit të Shqipërisë etnike. Në një perspektivë rajonale, kjo dëmton ndërtimin e stabilitetit dhe të bashkëpunimit midis shteteve në Ballkan. Po kështu, përveç penalizimeve të mundshme ndaj Shqipërisë dhe humbjes së energjisë dhe të kohës për të shpjeguar të kundërtën, nga ana tjetër, kjo është një mënyrë e sigurt për të ndaluar Shqipërinë që të luajë një rol udhëheqës në rajon, nëse dëshiron të luajë një rol të tillë, duke mbajtur parasysh faktorin shqiptar në të gjithë Ballkanin.

Së fundi, por jo e fundit për nga rëndësia, dogma e çështjes së bashkimit nuk e ndihmon, në mos e ndalon, procesin e rindërtimit të të dy shteteve dhe modernizimin e shoqërive respektive. Çlirimi nga dogma është vetëm hapi i parë për t'u larguar nga këto rreziqe.

- 42 Sipas një sondazhi të Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare të realizuar në gjysmën e parë të vitit 2019, 60 për qind do të votonin pro bashkimit, por sipas një sondazhi të IDRA “pro” do të votonin 75 për qind në Shqipëri dhe 63 përqind e të anketuarve në Kosovë.
- 43 *Albania Twenty Years After, People on state and democracy* (Tirana: Albanian Institute for International Studies AIIS, 2010)
- 44 *Rethinking Albania’s Foreign and Regional Policy*, Policy Paper (Tirana: Albanian Institute for International Studies AIIS, 2018)
- 45 Saracini, Klotilda. “Kosove-Shqiperi-rritet-bashkepunimi-per-shtim-te-volumit-te-shkembimeve-permes-portit-te-Durresit,” ATA.gov.al, 24/01/2020 <https://ata.gov.al/2020/01/24/kosove-shqiperi-rritet-bashkepunimi-per-shtim-te-volumit-te-shkembimeve-permes-portit-te-durresit/>
- 46 Saracini, Klotilda. “Kosove-Shqiperi-rritet-bashkepunimi-per-shtim-te-volumit-te-shkembimeve-permes-portit-te-Durresit,” ATA.gov.al, 24/01/2020 <https://ata.gov.al/2020/01/24/kosove-shqiperi-rritet-bashkepunimi-per-shtim-te-volumit-te-shkembimeve-permes-portit-te-durresit/>
- 47 Judah, Tim. 2009. *Yugoslavia is dead: long live the Yugosphere good news from the Western Balkans*. Papers on South Eastern Europe, Economides, Spyros and Kovanovic, Ivan (eds.) LSEE - Research on South Eastern Europe, London, UK.
- 48 Kalemaj, Ilir. 2020. “Albania and Kosovo Present and Future” on Tirana Observatory, Vol. 2, No.1 Winter 2020, p. 79- 85 , shiko edhe A. Rakipi, ‘Albania and Kosova - The Centrality Of Economics’, Tirana Times, 2015.
- 49 Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.
- 50 Intervistë me Arben Hajrullahun. Gusht 2019. Intervista me prof. Hajrullahun është përgatitur nga ekipi hulumtues i KIPRED. Autori dhe Instituti i Studimeve Ndërkombëtare u janë shumë mirënjohës kolegëve të KIPRED.
- 51 Intervistë me Anton Berishën. shtator 2019. Intervista është përgatitur nga ekipi hulumtues i KIPRED.
- 52 Intervistë me Jakup Krasniqin. shtator 2019. Intervista është përgatitur nga ekipi hulumtues i KIPRED.
- 53 Intervistë me Albin Kurtin, shtator 2019. Intervista është përgatitur nga ekipi hulumtues i KIPRED.
- 54 Intervistë me Arben Hajrullahun , shtator 2019. Intervista është përgatitur nga ekipi hulumtues i KIPRED.
- 55 Intervistë me Enver Robellin. shtator 2019. Intervista është përgatitur nga ekipi hulumtues i KIPRED.
- 56 Tirana Times. 2019. “Albania–Kosovo Relations: the show goes on”. Tirana Times, 2020. Accessed on 20/05/2020: <http://www.tiranatimes.com/?p=142612>

- 57 Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.
- 58 Rakipi, Albert. 2020. "Shqipëria dhe Kosova: Nga Lufta e Ftohtë të një agjendë strategjike, Europa vol. 7 Nr.1, Tirana. Accessed on 20/05/2020 <http://europa.com.al/index.php/2020/02/24/shqiperia-dhe-kosova-nga-lufta-e-ftohte-tek-nje-agiende-strategjike/>
- 59 Intervistë me Enver Robellin.
- 60 Gazeta Shqip. 2019. "Luftë tregtare mes vëllezërish, Kosova kërcënon me taksë Shqipërinë" 27 qershor. Accessed on 20/03/2020 <https://www.gazeta-shqip.com/2019/06/27/lufte-tregtare-mes-vellezerish-kosova-kercenon-me-takse-shqiperine/>
- 61 Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.
- 62 Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.
- 63 Rakipi, Albert. 2020. "Albania-Serbia Relations, From enthusiasm to Status quo, From status quo to false promise of a strategic agenda" on Tirana Observatory, Vol. 2, Nr 1, Winter 2020.
- 64 Tanner, Marcus. 2018. "Correcting Kosovo's Border Would Shake Postwar Europe's Foundations" on Balkan Insight: <https://balkaninsight.com/2018/08/24/correcting-kosovo-s-border-would-shake-postwar-europe-s-foundations-08-24-2018/>
- 65 Krasniqi, Ekrem and Retman Andrew. "US still open to Kosovo-Serbia land swap." EU Observer, 2020. <https://euobserver.com/enlargement/147484>
- 66 Gray, Andrew US open to Kosovo border changes, Trump adviser says Skeptics, including Germany, fear a land swap could spark violence. 8/24/18, 5:38 at <https://www.politico.eu/article/kosovo-border-changes-us-opinion-donald-trump-john-bolton/>
- 67 Asnjëherë nuk u bë e qartë se si mund të ndryshoheshin kufijtë e Serbisë dhe Kosovës, pa njohjen më parë nga secili të kufijve ekzistues.
- 68 Gjithashtu në postin e ministrit të arsimit u emërua një vajzë nga Kosova.
- 69 Të dy këto gjeste u pritën me habi dhe pavarësisht se nuk pati deklarime publike Prishtina la të kuptohet se nuk e aprovonte propozimin për një president të përbashkët. Kur Presidenti i Shqipërisë nuk e dekretoi kandidatin e kryeministrit për ministër të punëve të jashtme, kryeministri reagoi publikisht duke u shprehur se i kërkonte ndjesë Kosovës, për të forcuar idenë se kandidati për ministër nga Kosova përfaqësonte Kosovën në Qeverinë e Shqipërisë. Nga ana tjetër, Kryeministri i Kosovës Haradinaj iu përgjigj flakë për flakë duke theksuar se emërimet në Qeverinë e Shqipërisë ishin çështje e Shqipërisë dhe e Kryeministrit të Shqipërisë dhe jo e Republikës së Kosovës.
- 70 Për një analizë të plotë të kësaj nisme shih Agon Denjaha "Balkan Mini-Schengen: A Well Thought Regional Initiative or a Political Stunt?" Tirana Observatory, Winter 2020, Vol 2.
- 71 Katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, Lëvizja Vetëvendosja dhe LDK arritën të krijonin një qeveri të përbashkët, të kryesuar nga udhëheqësi i të parës. Qeveria qëndroi në detyrë vetëm pesëdhjetë ditë dhe u rrëzua pas një mocion mosbesimi nga partneri i saj LDK.

- 72 Rakipi, Albert. 2019. 'A new Rapprochement between Abania and Serbia: The implications for Kosovo', Vienna National Defence Academy, f. 79-100.
- 73 Edi Rama, Intervista për televizionin Serb Pink TV, cituar nga Alsat "Besoj se shqiptarët dhe serbët mund të bëjnë për Ballkanin atë që Franca dhe Gjermania bënë për Evropën" <https://www.alsat-m.tv/rama-shqiptaret-e-serbet-te-bejne-per-ballkaninate-qe-bene-franca-e-gjermania-per-evropen/> deklaroi Rama.
- 74 Rakipi, Albert. 2019. "A new Rapprochement between Abania and Serbia: The implications for Kosovo", Vienna National Defence Academy, f. 79-100.
- 75 Hulumtimi cilësor mbi perceptimet dhe vlerësimet e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, Raporti Përmbledhës (Tiranë: i pabotuar, 2018)
- 76 Hulumtimi cilësor mbi perceptimet dhe vlerësimet e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, Raporti Përmbledhës (Tiranë: i pabotuar, 2018)
- 77 Intervistë me R. A., ish zyrtar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
- 78 Hulumtimi cilësor mbi perceptimet dhe vlerësimet e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, Raporti Përmbledhës (Tiranë: i pabotuar, 2018)
- 79 Intervistë me Ilir Kalemaj, hulumtues.
- 80 Fokus grup, cituar në Kosovë-Shqipëri: Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi (Prishtinë: KFOS, Janar 2019)
- 81 Çela, Alba and Geron Kamberi, Rinia Shqiptare 2018/2019 (Tirana: Friedrich Ebert Stiftung, 2019)
- 82 Hulumtimi cilësor mbi perceptimet dhe vlerësimet e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, Raporti Përmbledhës (Tiranë: i pabotuar, 2018)
- 83 *Albania Twenty Years After, People on state and democracy* (Tirana: Albanian Institute for International Studies AIIS, 2010)
- 84 Elez Biberaj. 2020. *The Albanian National Question*. New York: New York Council of Foreign Relations Press.
- 85 Intervistë me Arjan Dymishin.
- 86 Albin Kurti, intervistë për Të Paekspozuarit, Top Channel, video, Tiranë, 29 maj 2018, "Një orë me Albin Kurtin" Kreu i Vetëvendosjes: Ja si bashkohet Shqipëria me Kosovën!
- 87 Berisha, Sali. Demokracia dhe Humanizmi - binom i pandarë (Tiranë: Gazeta Shqiptare ribot. 8 nëntor 2010)
- 88 Biberaj, Elez. *The Albanian National Question* (New York: New York Council of Foreign Relations Press, 2000)
- 89 Albania's PM meets Yugoslav President Albanian Telegraphic Agency (ATA) 1997.
- 90 Intervistë me Jakup Krasniqin, gusht 2019.
- 91 Intervistë me Arben Hajrullahun, gusht 2019.

- 92 Manifesti i Partisë Socialiste të Shqipërisë: <https://www.ps.al/programi/manifest-2017-2021> ; Programi politik i Partisë Demokratike: <https://pd.al/politika-e-jashtme/>; Platforma Politike e Lëvizjes Socialiste për Integrim: <http://www.lsi.al/platforma-politike/>
- 93 Aleanca Kuq e Zi, Spahiu: Shqipëria e Kosova të bashkohen (Bota Sot, 4 qershor 2012)
- 94 *Albania in the next ten years - envisioning the future* (Tirana: Albanian Institute for International Studies AIIS, 2012)
- 95 Rakipi, Albert. “Il Piemonte Albanese è Bruxelles” on Limes Revista Italiana di Geopolitica, Nr 2,2008 f. 99-106.

Kapitulli III

NJË BASHKIM EVENTUAL: CILAT JANË IMPLIKIMET?

Qysh nga koha kur Akademia e Shkencave e Shqipërisë bëri publike *Platformën për zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare*,⁹⁶ asnjëra prej qeverive shqiptare, që kanë ndërruar njëra-tjetrën gjatë dy dekadave të fundit, nuk ka ndërmarrë ndonjë hap konkret që mund të paralajmëronte se Shqipëria realisht e dëshiron bashkimin dhe po punon për këtë bashkim. Konceptimi i bashkimit kombëtar si bashkim i territoreve është i vlefshëm vetëm për t'u dhënë formë narrativëve nacionalistë dhe populistë, por sigurisht i pamjaftueshëm për të pretenduar një ide serioze për bashkimin. Bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës, si komponenti më i rëndësishëm i bashkimit kombëtar dhe i zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare në një rrafsh teorik dhe praktik është bashkimi i dy shteteve:⁹⁷ bash-

kimi dhe integrimi ekonomik, kulturor, ekonomik dhe integrimi i dy shoqërive, që do të kërkonte studime paraprake dhe një strategji të menduar mirë.

Megjithëse ideja e bashkimit duket të jetë popullore në Shqipëri, nuk ka asnjë lloj përpjekjeje për të përgatitur bashkimin. Asnjë parti politike në Shqipëri dhe Kosovë nuk është shprehur hapur kundër bashkimit, madje ato flasin me entuziazëm dhe gjithmonë përgjithësisht për këtë bashkim, por pavarësisht retorikës, elita politike në të dy vendet do të ndjehej e rrezikuar nga një bashkim eventual, që mund të çonte në humbjen e pushtetit.⁹⁸

Në narrativin e udhëheqësve politikë në Shqipëri, mbi-zotëron koncepti i bashkimit të territoreve, “i trojeve të ndara, padrejtësisht,” që duhet të bashkohen. Në vitin 2012, në festimet për 100 vjetorin e pavarësisë, Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha bëri thirrje nga Shkupi për bashkimin kombëtar,⁹⁹ por kjo thirrje, që u pa me shqetësim në Perëndim dhe në rajon,¹⁰⁰ si një provë e përpjekjeve të Shqipërisë për të krijuar një Shqipëri të Madhe, në fakt, nuk u shoqërua me ndonjë nismë konkrete nga qeveria e asaj kohe.

Gjatë pesë-gjashtë vjetëve të fundit, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka adoptuar pak a shumë të njëjtën qasje populiste për bashkimin, qasje që sërish ka në themel konceptin e bashkimit të territoreve, por pa artikuluar ndonjë ide konkrete për këtë bashkim. Me një gjuhë kontradiktore Tirana i është rikthyer idesë së bashkimit si alternativë ndaj integritimit në BE. Nëse BE nuk është e gatshme të avancojë integrimin e Shqipërisë dhe ta pranojë anëtarësimin e saj në BE, atëherë

shqiptarët do të bashkohen në Ballkan,¹⁰¹ që më shumë se një hap i ri në çështjen e bashkimit, tingëllon si një shantazh për Brukselin apo vendet anëtare. Mirëpo a do të këmbenin qytetarët e Shqipërisë dhe të Kosovës integrimin evropian të shteteve të tyre me bashkimin e këtyre shteteve, apo me bashkimin kombëtar për realizimin e të cilit do të duhen të shkëputen territore nga tre shtete të tjera në Ballkan? Në fakt, as në Shqipëri dhe as në Kosovë qytetarët nuk e shikojnë bashkimin kombëtar si një alternativë ndaj të ardhmes europiane, të anëtarësimit në BE. Midis dy opsioneve ata kanë zgjedhur me 84,7 për qind në Shqipëri dhe 66,4 për qind në Kosovë, integrimin evropian përkundër opsionit të bashkimit.

E vetmja ide për bashkimin, i cili, që në pamje të parë duket konkret, është propozimi i Kryeministrit të Shqipërisë, dy vjet më parë, për një president të përbashkët.¹⁰² Të propozosh fillimin e bashkimit të dy shteteve me emërimin apo zgjedhjen e një presidenti të përbashkët, e pakta që mund të thuhet është se Shqipëria nuk ka një vizion apo një strategji të qartë për bashkimin: madje nuk ka asnjë ide serioze për këtë bashkim. Ky propozim madje nuk ndihmoi as inkurajimin e një debati për një aspekt tjetër të bashkimit, për të cilin shumica duket se është dakord. A është i mundshëm bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës nëse e marrim të mirëqenë se bashkimi është i dëshirueshëm? A ekzistojnë pengesa dhe cilat janë këto? A ekzistojnë frikëra nga një bashkim eventual i të dy shteteve? Dhe së fundi, çfarë implikimesh potenciale mund të ketë në rastin e një bashkimi eventual të të dy shteteve? Shqyrtimi i këtyre çështjeve do të bënte të mundur daljen nga miti dhe çlirimi nga dogma, me të cilën është mbyllur, përmes të cilave është ndërtuar dhe funksionon narrativi rreth bashkimit.

Shqetësimet, kufizimet dhe pëlqimi nga fuqitë e mëdha

Formalisht, nga pikëpamja e të Drejtës Ndërkombëtare, konventave ndërkombëtare përkatëse, Shqipëria nuk ka ndonjë pengesë për t'u bashkuar me një shtet tjetër - sigurisht nëse kjo ndodh në mënyrë paqësore dhe me pëlqimin e të dy shteteve. Po kështu, në dokumentet themelore të Shqipërisë, në kushtetutën e saj nuk ka asnjë pengesë që një shtet tjetër, praktikisht Kosova, të bashkohet me Shqipërinë ose Shqipëria të bashkohet me Kosovën. Në pamje të parë të krijohet madje përshtypja se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë është një detyrim që rrjedh nga ligji themelor, kushtetuta. Shpeshherë, politikanët shqiptarë në Republikën e Shqipërisë i referohen kushtetutës në narrativin e tyre rreth çështjes kombëtare në përgjithësi edhe kur flasin për Kosovën dhe të ardhmen e saj në veçanti. Mirëpo një vëzhgim më i kujdesshëm provon se ndërsa nuk ka ndonjë pengesë që Shqipëria të bashkohet me ndonjë shtet tjetër apo me Kosovën në veçanti, ligji themelor, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk përmban detyrime ligjore respektive për këtë bashkim. Përmes një gjuhe të përgjithshme në preambulën e kushtetutës thjesht deklarohet se: “Ne, populli i Shqipërisë, jemi krenarë me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar;”¹⁰³ por në asnjë nen të kushtetutës nuk flitet për bashkimin kombëtar apo bashkimin me Kosovën.

Nga ana tjetër, ky nuk duket të jetë rasti i Kosovës.¹⁰⁴ Sipas kushtetutës së vet, Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.¹⁰⁵ Për rrjedhojë, çdo ide për bashkim të Kosovës me një shtet tjetër, përfshi sigurisht

Shqipërinë, nuk është i mundur pa ndryshuar kushtetutën dhe pa abroguar nenin e mësipërm. Megjithatë, në një rrafsh teorik, edhe në rastin e Kosovës nuk janë të pamundshme ndryshimet kushtetuese, që teorikisht nuk do të pengonin bashkimin me një shtet tjetër, me Shqipërinë.¹⁰⁶

Sidoqoftë, edhe në rastin e Shqipërisë, ku aktualisht nuk ka asnjë pengesë ligjore që buron nga ligji ndërkombëtar ose kushtetuta e vendit dhe që do të pengonte bashkimin e Shqipërisë me një shtet tjetër, edhe në rastin e Kosovës kur Kushtetuta e ndalon bashkimin me shtete ose territore të tjera (pengesë që gjithsesi mund të shmanget) çështja e bashkimit të të dy vendeve është shumë më shumë se sa thjesht aspekti ligjor formal.

Në një rrafsh praktik, krahas aspekteve ligjore të brendshme (kushtetutat) ose ndërkombëtare (E Drejta Ndërkombëtare), një rol deri përcaktues luajnë faktorë politikë, gjeopolitikë, historikë, gjeografikë, ekonomikë, kulturorë, religjiozë, të cilët mund ta bëjnë bashkimin e të dy shteteve një sipërmarrje të pamundur edhe kur ekziston vullneti i të dy këtyre vendeve dhe nuk ka pengesa ligjore.

Pikë së pari, bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, në çfarëdolloj forme që të propozohet ky bashkim, nuk do të ishte i mundur *pa pëlqimin e* Fuqive të Mëdha apo të Komunitetit Ndërkombëtar. Kur është fjala për politikën e jashtme, partitë politike edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, i referohen ekskluzivisht Komunitetit Ndërkombëtar dhe në mënyrë të veçantë shteteve që si Shqipëria, ashtu edhe Kosova, i kanë shpallur partnerë strategjikë(!), në të cilat përfshihen së pari dhe kryesisht SHBA dhe Bashkimi Europian. Referimet për çështjen

kombëtare pothuajse në të gjitha programet e partive politike në Shqipëri dhe Kosovë janë të zbehta dhe gjithë ekuivoqe. Në çdo rast, udhëheqësit politikë shqiptarë në të dyja anët e kufirit janë të kujdesshëm t'i referohen *Komunitetit Ndërkombëtar* dhe *partnerëve strategjikë* për avancimin apo zgjidhjen e çështjeve kombëtare.

Në këtë aspekt, teza për zgjidhjen e çështjes kombëtare në programet politike të partive politike në të dy vendet është e njëjtë me tezën e paraqitur në platformën “nacionaliste”¹⁰⁷ për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare të Akademisë së Shkencave, e cila si rrugë të vetme të zgjidhjes propozon bashkëpunimin me komunitetin ndërkombëtar “në përputhje me parimet e deklaruara universalisht mbi të Drejtat e Njeriut dhe të drejtën e vetëqeverisjes.”¹⁰⁸

Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete të vogla dhe për të gjitha shtetet e vogla pavarësia, sovraniteti dhe kapacitetet për të operuar në mjedisin ndërkombëtar janë përgjithësisht të limituara. Por Shqipëria dhe Kosova janë gjithashtu edhe shtete të dobëta, me një varësi kritike nga komuniteti ndërkombëtar.¹⁰⁹

Pavarësia e Kosovës ka qenë edhe një konsensus midis Fuqive të Mëdha, si SHBA, Britania e Madhe, Gjermania dhe të tjera, në një periudhë të caktuar të ekuilibrave ndërkombëtare. Çdo ndryshim radikal, nga pavarësia e Kosovës te ideja e bashkimit me Shqipërinë do të kërkonte të njëjtën mbështetje dhe angazhim të Fuqive Perëndimore, si në vitin 1999, kur NATO vendosi të ndërhyjë ushtarakisht apo në 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë, si edhe një vlerësim realist të sjelljes së aktorëve të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë, të cilët kanë qenë kundër pavarësisë së Kosovës.¹¹⁰

Bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, në çfarëdolloj forme, do të çonte në ndryshimin e hartës politike të Ballkanit. Ndryshimet e mëparshme, përfshirë edhe ato më të fundit, janë shoqëruar me konflikte të përgjakshme brenda shteteve dhe midis shteteve, si dhe me ndërhyrjen e fuqive të treta, SHBA-së dhe Fuqive Europiane.

Megjithëse ndryshimi i hartës politike në Ballkan, pas një bashkimi eventual të Shqipërisë dhe Kosovës, do të ndodhte me pëlqimin dhe vullnetin e të dy shteteve - nëse do të ndodhte - rreziku i konflikteve dhe i dhunës në rajon nuk mund të përjash-tohet me siguri.¹¹¹ Në njëfarë mënyre, ky ndryshim potencial i hartës politike do të kërkonte një lloj pëlqimi edhe nga vendet fqinje me Shqipërinë dhe Kosovën, pëlqim që është e vështirë të besohet se Serbia, për shembull, është e gatshme ta japë.¹¹²

Krijimi i një shteti të ri nga bashkimi i Shqipërisë, një shtet pothuajse etnikisht i pastër, me Kosovën, gjithashtu me një shumicë dërrmuese etnike shqiptare, mund të krijonte idenë e krijimit të shteteve etnikisht të pastra. Në Ballkan kjo duket një mision i pamundur, pa harruar se kjo do të përbënte një filozofi të cilën BE dhe SHBA e kanë kundërshtuar ose të paktën nuk e favorizojnë.

Pavarësisht nga lojërat “nacionaliste” dhe “ushtrimet” e herë pas herë populiste, Tirana ka qenë e kujdesshme në politikën e saj në Ballkan dhe Perëndimi i ka njohur një rol konstruktiv me të cilin Shqipëria krenohet, rol përgjithësisht i supozuar që praktikisht është: asnjë ambicie për ndryshimin e kufijve në favor të një shteti më të madh shqiptar dhe mbështetje pa rezerva e politikave të Perëndimit, Bashkimit Europian dhe SHBA-së. Gjithashtu, ekziston një pikëpamje e konsoliduar në publikun

shqiptar, sipas të cilit bashkimi i Shqipërisë me Kosovën mund të ndodhë vetëm nëse pranohet dhe ka mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar,¹¹³ roli i të cilit perceptohet si përcaktues.¹¹⁴

Të gjithë mbështetësit e bashkimit kombëtar, si edhe nacionalistët, edhe populistët, madje edhe ata që realisht e mbështesin kauzën e bashkimit me naivitet, të gjithë i referohen interesit kombëtar,¹¹⁵ pa një shqyrtim kritik nëse bashkimi i shërben realisht interesit kombëtar, definicioni për të cilin mbetet në mënyrë të qëllimshme ose jo, gjithsesi, shumë i vagullt dhe i paqartë.

Nëse konsolidimi i shtetësisë së Kosovës në mjedisin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar është në interes jo vetëm të Prishtinës, por edhe të gjithë shqiptarëve, pra, është një interes kombëtar, është e qartë se çdo ide për bashkim me Shqipërinë do të dëmtonte seriozisht shtetësinë dhe pavarësinë e Kosovës.¹¹⁶

Krahas pengesave të mësipërme ekzistojnë droje dhe deri frikë në shoqëritë e të dy vendeve, Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat kanë funksionuar të ndara historikisht. Një nga arsyet e atyre që janë kundër bashkimit, si në Shqipëri edhe në Kosovë, është një lloj frike se Shqipëria dhe Kosova do të funksiononin më mirë si dy shtete të pavarura, se sa të bashkuara në një shtet.¹¹⁷

Teza, sipas të cilës, bashkimi është një domosdoshmëri për të pasur një shtet të suksesshëm, funksional, demokratik, që siguron për qytetarët standarde të larta ekonomike dhe shërbimet bazë, sigurinë, drejtësinë, edukimin, shërbimin shëndetësor, infrastrukturën e të tjera, është gjithmonë e më pak pjesë e narrativit të bashkimit në të dy anët e kufirit.¹¹⁸ Është e paqartë dhe

sigurisht e pasigurt se si bashkimi do të sjellë automatikisht rritjen e cilësisë së demokracisë apo standarde të larta ekonomike, në edukim apo në shërbimet e tjera themelore.¹¹⁹

Madje nuk është fort e pamundshme që bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë, dy shtete të vogla, të dobëta, me ekonomi të varfra, mund të çonte në krijimin e një shteti më të madh, por sigurisht të dobët, në mos të dështuar.¹²⁰

Bashkimi mund të jetë i mundshëm, kur, së pari, njëra nga pjesët etnike ka arritur të krijojë një shtet të fortë e të qëndrueshëm, me potencial politik dhe ekonomik, pra, që ka gravitetin e mjaftueshëm për të tërhequr drejt vetes pjesën tjetër të kombit si dhe të jetë i aftë të përballojë kostot ekonomike të bashkimit mes shteteve.

Ekziston gjithashtu një frikë jo shumë publike se dallimet kulturore dhe traditat e ndryshme, që të dy shoqëritë kanë zhvilluar gjatë njëqind vjetëve të fundit, mund të mos e ndihmojnë bashkimin, por përkundrazi mund të shndërrohen në pengesa serioze që mund të çojnë edhe në acarimin e marrëdhënieve aktuale midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Në Kosovë ekziston frika se bashkimi do të “linte në hije” Kosovën; kryeqyteti do të ishte Tirana, Presidenti do të zgjidhej nga Shqipëria; institucionet e tjera të shtetit, që do të krijoheshin nga bashkimi, do të udhëhiqeshin gjithashtu nga shqiptarët e Shqipërisë. Ky shtet do të menaxhohej nga shqiptarët e Shqipërisë ngaqë “Shqipëria posedon resurse më të mëdha ekonomike, politike, akademike” dhe përfundimisht kosovarët do të mbeteshin nën hijen e Shqipërisë.¹²¹

Implikime në mjedisin ndërkombëtar

Një bashkim eventual i Shqipërisë me Kosovën, duke supozuar një rast ideal në të cilin ka një vullnet të plotë të dy shteteve dhe mbështetje popullore të shoqërive respektive, do të çonte në krijimin e një shteti, funksionaliteti dhe madje ekzistenca e të cilit, do të ballafaqohej me dilema jetike në mjedisin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, mjedise të cilat operojnë jo në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Analiza e implikimeve të mundshme, që do të rridhnin nga një bashkim eventual i Shqipërisë dhe Kosovës duhet të përfshijë dy rrafshë:

Së pari, implikimet e mundshme për Shqipërinë dhe Kosovën,¹²² si edhe implikimet për produktin e bashkimit, në mjedisin ndërkombëtar: Ligji Ndërkombëtar, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara, NATO dhe Bashkimi European.

Së dyti, por po aq të rëndësishme, implikimet e mundshme për produktin e bashkimit, në mjedisin e brendshëm, që do të rrjedhin nga procesi i bashkimit të dy shteteve.

Përpara se të analizohen implikimet potenciale në të dy këto rrafshë është e rëndësishme të identifikohen mundësitë teorike të bashkimit si dhe natyra e produktit që do të sjellë bashkimi.

Prej shpalljes dhe njohjes së Kosovës si shtet i pavarur, bashkimi i Shqipërisë me Kosovën mund të ndodhë si bashkim i dy shteteve të pavarura. Në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës nuk mund të aplikohet koncepti i ribashkimit të dy shteteve, të cilat dikur kanë qenë pjesë të një shteti unitar, siç është rasti i dy Gjermanive, për arsyen e thjeshtë se Shqipëria dhe Kosova nuk kanë qenë kurrë pjesë të një shteti të përbashkët.¹²³

Mundësitë për një bashkim eventual mund të jenë: bashkimi

i dy shteteve dhe krijimi i një entiteti të ri; absorbimi i njërit prej shteteve nga shteti tjetër dhe rasti më i mundshëm do të ishte absorbimi i Kosovës nga Shqipëria. Ndonëse edhe e kundërta, absorbimi i Shqipërisë nga Kosova nuk mund të përjashtohet teorikisht, gjithsesi do të ishte më pak i argumentuar dhe i arsyeshëm për shkak të legjitimitetit jo të plotë të Kosovës nga fakti i mosnjohjes nga të gjithë anëtarët e OKB-së, përfshirë disa prej anëtarëve të Këshillit të Sigurimit apo pesë vende anëtare të BE-së.

Një variant tjetër do të ishte bashkimi në një konfederatë, kur të dy shtetet përbërëse do të ruanin sovranitetin e tyre në mjedisin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, me një qeverisje qendrore të dobët. Rasti më i fundit ishte Bashkimi i Serbisë me Malin e Zi, në vitin 2003, që u shpërbë në vitin 2006.

Në të gjitha variantet e bashkimit do të jetë si parakusht një marrëveshje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë, që do t'i jepte fund legjitimitetit të cunguar të së parës. Përndryshe, në të gjitha skenarët teorikë bashkimi do të mbartte një marrëdhënie konfliktuale midis Shqipërisë dhe Serbisë: Shqipëria dhe Kosova do të bashkoheshin dhe do të krijonin një shtet të ri, por një pjesë të territorit të këtij shteti të ri do të vijonte ta pretendonte Serbia. Në mënyrë të ngjashme, edhe në rastin kur Shqipëria do të absorbonte Kosovën, do t'i duhej të hynte në konflikt me Serbinë për faktin se kjo e fundit pretendon territorin e Kosovës.

Çdo tentativë e Shqipërisë dhe Kosovës për të shkuar drejt bashkimit, në kushtet e konfliktit të ngjirë midis Serbisë dhe Kosovës, do të mbartte rrezikun e një konflikti midis Shqipërisë dhe Serbisë, kurse çdo marrëveshje midis Shqipërisë dhe Serbisë për të zgjidhur këtë konflikt do të çonte në humbjen e pavarësisë së Kosovës dhe copëtimin e territorit të kësaj, si dhe në

ndarjen e këtij territori midis Shqipërisë dhe Serbisë.

Duke supozuar se një bashkim eventual midis Shqipërisë me Kosovën ndodh pasi kjo e fundit arin një marrëveshje me Serbinë, që ka në themel njohjen reciproke si dy shtete të pavarura, cilat do të ishin implikimet në mjedisin ndërkombëtar për Shqipërinë, Kosovën dhe për produktin e bashkimit.

Pyetja e parë, themelore, ka të bëjë me njohjen ndërkombëtare, pavarësisht nga forma e bashkimit. Në të dy rastet, kur nga krijimi i dy shteteve krijohet një shtet i ri apo në rastin kur Kosova i bashkohet Shqipërisë, pyetja dhe dilema themelore është: a do të duhej njohje formale ndërkombëtare për shtetin që krijohet nga bashkimi dhe çfarë gjasash ka që kjo të ndodhë? Çfarë implikimesh mund të sjellë kjo në procesin e njohjes ndërkombëtare? Është sigurisht mjaft hipotetike, por ndërkaq shumë e domosdoshme analiza e zhvillimeve dhe implikimeve të mundshme në rastin e supozuar të nevojës së njohjes ndërkombëtare. Pa miratimin e fqinjëve dhe sidomos të Fuqive të Mëdha, procesi i njohjes ndërkombëtare do të jetë shumë i vështirë, i gjatë dhe në asnjë rast i garantuar. Kjo do ta ndërlikonte funksionalitetin e brendshëm të shtetit dhe ndoshta do të vinte në pikëpyetje vetë ekzistencën e tij. Në të dy rastet, edhe në atë të krijimit të një shteti të ri, edhe në atë të zmadhimit të njërit prej shteteve duke i bashkuar tjetrin, janë një sërë pyetjesh të cilat në fakt e errësojnë shumë perspektivën e bashkimit dhe ngrenë çështje shumë kritike.

A do të jenë të vlefshme marrëveshjet ndërkombëtare që secili shtet ka nënshkruar me shtete të tjera? A do ta trashëgojë shteti që do të jetë produkt i bashkimit, anëtarësinë në institucione dhe

organizata ndërkombëtare? A do të ishte automatikisht shteti i ri anëtar i NATO-s, ngaqë njëri prej shteteve themeluese, Shqipëria, është anëtare e kësaj aleance? A do të ishte e gatshme Aleanca të “njihnte” anëtarësinë e shtetit, që do të krijohet nga bashkimi?

Rasti i vazhdimësisë së anëtarësisë në NATO i Gjermanisë së bashkuar tregon se është i domosdoshëm jo vetëm miratimi i vendeve anëtare, që buron nga vetë traktati i Aleancës dhe procedurat e zgjerimit me anëtarë të rinj, por edhe nga një *pëlqim* që shkon përtej aleancës, në mënyrë të veçantë ai i Fuqive të Mëdha. Pas bashkimit të dy Gjermanive, SHBA ishin shumë të interesuara dhe mbështetën vijimin e anëtarësisë në NATO për Gjermaninë e Bashkuar dhe Bashkimi Sovjetik, i dobësuar dhe në prag të shpërbërjes e dha pëlqimin e vet.¹²⁴ Kësisoj, në rrethana të reja dhe duke mbajtur parasysh faktin se edhe Shqipëria, edhe Kosova, janë dy shtete të vogla, është e qartë se edhe bashkimi i tyre e sigurisht, edhe anëtarësia në aleancë kërkon pëlqimin e të tretëve dhe së pari, pëlqimin e *të mëdhenjve*, qofshin ata anëtarë të NATO-s ose jo anëtarë.

Nga ana tjetër, është mjaft hipotetike, por gjithsesi do të ishte e vështirë që, së pari, anëtarët e Aleancës të pranonin t’i njihnin Shqipërisë anëtarësinë në NATO, një shteti që do të dilte nga bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës, kur një numër anëtarësh, të paktën këto që nuk njohin ende Kosovën, nuk do të ishin të gatshme të njihnin as shtetin që do të krijohet. Po kështu, është e dyshimtë nëse Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, dy anëtarët ballkanike të aleancës dhe fqinjët e Shqipërisë do të mbështesnin vazhdimësinë e anëtarësisë në NATO për shtetin që potencialisht mund të krijohet nga bashkimi, të paktën për dy arsye: një shtet më i madh, që do të përfshinte popullsi dhe territore të ish-Shqipërisë otomane mund të shërbente si model dhe frymëzim

për minoritetet shqiptare në të dy këto vende, në idenë e bashkimit me “atdheun mëmë”. Së dyti, një Shqipëri e zgjeruar dhe anëtare e Aleancës do të impononte një rikonfigurim të balancave dhe do të linte në hije të dy këto vende pavarësisht anëtarësisë së tyre në NATO. Një Shqipëri e bashkuar me Kosovën dhe anëtare e Aleancës sigurisht që do të rriste fuqinë ushtarake, njerëzore, ekonomike, dhe sakaq do të zhvendoste balancën e fuqisë *vis-à-vis* Serbisë.¹²⁵ Kufiri i Kosovës me Serbinë do të ishte në të njëjtën kohë edhe kufiri i Aleancës me Serbinë, e cila vijon të mbajë ende një marrëdhënie jo shumë miqësore me NATO-n, ndërsa ka një marrëdhënie preferenciale me Rusinë. Kësisoj trashëgimia e anëtarësisë në NATO për shtetin që krijohet nga një bashkim eventual do të kontribuonte në mënyrë substanciale te rivalitetet gjeopolitike, që edhe aktualisht janë mjaft të shprehura në Ballkan.

Të gjithë argumentet e mësipërme të çojnë në përfundimin se një bashkim i Shqipërisë me Kosovën do të rrezikonte seriozisht anëtarësimin e Shqipërisë në Aleancë. Çdo analogji me rastin e bashkimit të Gjermanisë nuk duket të jetë relevant me rastin e një bashkimi të mundshëm të Shqipërisë me Kosovën për një numër arsyesh, por themelore mbetet arsyeja se ndërsa në rastin e Gjermanisë çështja nuk ishte nëse anëtarësia e Gjermanisë Perëndimore në NATO mund të ishte një pengesë për bashkimin, siç është në rastin potencial Shqipëri-Kosovë, por nëse Gjermania e bashkuar duhej të trashëgonte anëtarësinë në Aleancë që ish-Gjermania Perëndimore e kishte përpara bashkimit.¹²⁶

Të njëjtat dilema qëndrojnë edhe për sa i takon statusit të vendit kandidat, që Shqipëria ka aktualisht në BE. A do të ishte e mundshme që shteti i ri të trashëgonte statusin e vendit kandi-

dat për në BE ngaqë njëri prej anëtarëve themelues, Shqipëria, aktualisht e gëzon këtë status? A do të ishte e gatëshme BE të vijonte bisedimet për anëtarësimin e Shqipërisë ¹²⁷ nëse kjo e fundit do të jetë duke “negociuar” bashkimin me Kosovën? Në mënyrë të ngjashme, a do të vijonte shteti i ri të ishte anëtar i INTERPOL, kur njëri prej shteteve themeluese, Kosova, nuk e ka këtë anëtarësi? Po kështu a do ta humbiste Shqipëria anëtarësinë në NATO, OKB, OSBE, Këshillin e Europës dhe institucione e organizata të tjera ndërkombëtare?

Dilema e sigurisë në nivelin lokal

Në çfarëdoj bashkimi, çështja themelore është ajo e funksionalitetit. Suksesi i bashkimit të Shqipërisë dhe Kosovës në të tre opsionet e mundshme, që kurrsesi nuk mund të jetë një bashkim mekanik, përcaktohet nga shkalla e funksionalitetit të shtetit të ri, që do të krijohet. Në rastin e bashkimit eventual të Shqipërisë dhe Kosovës, dy shtete aktualisht të dobëta me një shkallë të ulët funksionaliteti, çfarë gjasash ka për të përfutur nga bashkimi një shtet të fortë¹²⁸ dhe funksionues?

Shqipëria dhe Kosova nuk kanë funksionuar kurrë në një shtet të përbashkët. Në Shqipërinë otomane ato kanë funksionuar si vilajete më vete (mini-shtete) pa pasur një strukturë të përbashkët hierarkike shtetërore. Për një periudhë shumë të shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria dhe Kosova “u bashkuan,” por gjithsesi ky bashkim ishte larg nga një strukturë shtetërore hierarkike funksionale që kanë shtetet moderne. Pas Luftës së Dytë Botërore, të dy vendet dhe të dy shoqëritë kanë funksionuar të ndara dhe të izoluar në mënyrë ekstreme,

jo vetëm gjatë Luftës së Ftohtë, por edhe në pothuajse dy dekadat e para pas rënies së komunizmit.

Shtet-formimi në të dy vendet është relativisht i ri, por të dy vendet kanë kaluar nëpër përvoja të ndryshme dhe jo aq të ngjashme, kur flasim për burokracinë shtetërore, organizimin ekonomik, marrëdhëniet me pronën, që buronin nga fakti se përballë një Shqipërie, që aplikoi ekonominë e komanduar, Kosova nën Jugosllavi ishte një vend *quasi* kapitalist, çka imponon një kulturë të shtetit ligjor. Megjithëse ekzistojnë diferenca mes tyre, të dy vendet dhe shoqëritë kanë ndërkaq ngjashmëri jo të pakta kur është fjala për kulturën politike, organizimin e shoqërisë dhe të shtetit mbi baza klanore, lidhjeve të gjakut, të krahinës. Këto ngjashmëri jo vetëm që nuk e lehtësojnë integrimin, krijimin e shtetit të përbashkët, por përkundrazi mund të përbëjnë pengesa serioze për të shkuar drejt bashkimit. Ndërsa është e sigurt se ngjashmëritë e mësipërme janë një “garanci” më shumë që shteti i përbashkët do të vijonte të ishte i dobët, nëse jo i dështuar, pavarësisht se do të ishte më i madh në popullsi dhe në territore.

Kur është fjala për çështjen e funksionimit të shtetit shqiptar, duket se jemi përballë një paradoksi të madh. Më shumë se njëqind vjet më parë, kur u themelua dhe filloi të njihej shteti shqiptar, argumenti pse Kosova dhe territoret e tjera të Shqipërisë otomane duhet të ishin pjesë e shtetit shqiptar lidhej pikërisht me çështjen e qëndrueshmërisë së shtetit dhe të funksionimit të tij. Pa Kosovën, pa territoret dhe pa popullsinë respektive, shteti shqiptar nuk mund të ishte i qëndrueshëm dhe funksional.

Tani, pas më shumë se njëqind vjetësh, mbizotëron frika dhe dyshimi se nga bashkimi i Shqipërisë me Kosovën mund të lindë

një shtet edhe më i dobët, me një shkallë funksionimi edhe më të ulët, krahasuar me shtetin aktual në Shqipëri dhe në Kosovë.

Rasti i bashkimit të dy Gjermanive nuk është ndihmues në analizën e implikimeve potenciale të rastit të Shqipërisë dhe Kosovës, të paktën për dy arsye: rasti i dy Gjermanive është bashkimi i një shteti të ndarë, gjë që nuk është ashtu në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës.

Së dyti, bashkimin e Gjermanive e udhëhoqi Gjermania Perëndimore, e cila përbëhet nga një model, në themel të së cilit qëndron një kulturë politike dhe ideologji organizuese e shtetit, ku dominon shteti ligjor, ekonomia kapitaliste konkurruese, një model, të cilit nuk i afrohet as Shqipëria, as Kosova. Dhe me gjithë këtë epërsi të Gjermanisë Perëndimore, për bashkimin me Gjermaninë Lindore u deshën disa dekada, megjithëse për bashkimin e plotë, në kuptimin e integritimit dhe funksionimit, nuk mund të flitet ende me siguri.

Në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës asnjëra nga pjesët etnike nuk ka arritur të krijojë një shtet të fortë e të qëndrueshëm, me potencial politik dhe ekonomik, pra, që të ketë gravitetin e mjaftueshëm për të tërhequr drejt vetes pjesën tjetër të kombit si edhe të jetë i aftë të përballojë kostot ekonomike të bashkimit mes shteteve.¹²⁹

Ndërkohë që ekzistojnë pasiguri të mëdha lidhur me mundësinë dhe suksesin e bashkimit të Shqipërisë, si edhe për cilësinë, kapacitetet dhe shkallën e funksionalitetit të shtetit, që mund të krijohej nga bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës, nuk është e sigurt që ky bashkim, për të cilin të gjithë duket se janë dakord, është i çliruar edhe nga konfliktet e mundshme. Periudha e shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur ndodhi

bashkimi dhe u krijua një shtet i përbashkët midis Shqipërisë dhe Kosovës, në veçanti, nuk ishte e çliruar prej konflikteve të brendshme,¹³⁰ ndonëse Shqipëria gjermane nuk ishte në fakt një shtet i mirëfilltë, i integruar, me burokraci dhe institucione qendrore dhe lokale.¹³¹ Gjatë kësaj periudhe, u pa qartë se nuk ishte i lehtë akomodimi dhe integrimi i komuniteteve fetare dhe u krijuan përplasje midis komuniteteve fetare islame të Shqipërisë dhe Kosovës dhe për herë të parë edhe midis komuniteteve fetare dhe institucioneve shtetërore.¹³² Po kështu, përpjekjet e Ministrisë së Brendshme, të drejtuar nga Xhafer Deva për të vendosur rregull me dorë të hekurt në Shqipëri, me kontingjente të ardhura nga Kosova, u pa me shumë rezerva në Tiranë.

Duke mos qenë kurrë në një shtet të integruar dhe në kushtet e një mungese shumë të gjatë komunikimi midis shoqërive, a do të ishte bashkimi i Shqipërisë me Kosovën një krijesë e lirë dhe immune nga konflikti politik, i cili duket të jetë një tipar karakteristik i funksionimit të politikës edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë?

Aktualisht legjitimiteti, funksionaliteti dhe kapacitetet aktuale të shtetit në Shqipëri dhe Kosovë, përveç të tjerash, janë gërryer në një shkallë të lartë edhe për shkak të mosmarrëveshjeve, konflikteve të thella politike midis partive dhe udhëheqësve politikë në secilin vend, për shkak të logjikës *zero sum game* që aplikojnë partitë dhe udhëheqësit në lojën e tyre për pushtet, vështirësive për të arritur konsensus dhe për të bashkëpunuar me njëra tjetrën për të çuar përpara procesin e ndërtimit të shtetit.

Qysh nga rënia e komunizmit në Shqipëri dhe qysh nga parvarësia e Kosovës, të dy vendet janë përfshirë në cikle krizash, në rastin e Shqipërisë në kriza të thella si ajo e vitit 1997, zgjidhja e të cilave ka kërkuar ndërhyrjen e komunitetit ndërkombëtar. Edhe për çështje bazike, si mbajtja e zgjedhjeve, pranimi

i rezultateve e deri te ndërtimi i kabineteve dhe ndërtimi i administratave, është kërkuar dhe kërkohet ndihma e komunitetit ndërkombëtar si ndërmjetësues.¹³³

Nuk ka asnjë arsye dhe siguri që, *pas bashkimit*, konfliktet e thella dhe mosmarrëveshjet kronike politike në Tiranë dhe në Prishtinë do të shuhën. Madje nuk është pa gjasa që konflikteve politike brendapërbrenda secilës pjesë (kupto Shqipërisë dhe Kosovës) t’iu shtohet një konflikt i ri politik midis Tiranës dhe Prishtinës edhe në rastin kur të dy qendrat janë marrë vesh se kush do të jetë *Piemonti* i bashkimit.

Por çështja nuk qëndron vetëm te konfliktet potenciale politike, që do të merrnin një dimension të ri në rast të një bashkimi eventual. Këtu nuk mund të përjashtohen as përplasjet religjioze, kulturore dhe për çështjet ekonomike.

Nga pikëpamja teorike, bashkimi i Shqipërisë me Kosovën në një shtet të vetëm do të krijonte kushtet për atë që Barry Posen e përkufizon si *shfaqja e anarkisë*,¹³⁴ që nuk do të vijë nga rënia e një *rendi perandorak*, siç ka qenë rasti i rënies së Bashkimit Sovjetik apo Federatës Jugosllave, por nga rënia e rendit shtetëror në të dy vendet, për të shkuar drejt një rendi të ri, që vjen nga bashkimi. Ndërsa grupe etnike, që përfaqësojnë kombe të ndryshme, që dikur kishin jetuar në paqe nën *rendin perandorak*, vihen përballë dilemës së sigurisë kur ky rend perandorak bie, në mënyrë të ngjashme edhe komunitete të krijuara nga ideologji të ndryshme, politike apo doktrina të ndryshme fetare, faktorë ekonomikë, kulturorë, urbanë apo gjeografikë, gjithashtu mund të vihen përballë një dileme të sigurisë dhe mund të përfundojnë në konflikte dhe dhunë për të mbajtur ose për të avancuar statuset e tyre në kushtet e reja të bashkimit të Shqipërisë dhe Kosovës në një shtet të vetëm. Një bashkim

eventual i Shqipërisë dhe Kosovës ka potencialin të influencojë negativisht tri balanca, të cilat është dashur për t'u vendosur një shekull, nga të cilat gjysma e tij, 50 vite, nën një dhunë brutale: balancën Veri-Jug në favor të së parës, balancën aktuale fetare (midis myslimanëve, ortodoksëve, katolikëve dhe bektashinjve) në favor të myslimanëve, si dhe balancën midis rajoneve urbane kundrejt atyre rurale.¹³⁵

Prishja e këtyre balancave gjeografike, fetare, urbane/rurale, do të çonte në nxitjen e dilemave të sigurisë për komunitetet respektive dhe për rrjedhojë, në konflikte potenciale.

SHËNIME

- 96 Shiko "Platform For the Solution of the National Albanian Question," Academy of Science of Albania, Tiranë 1998, Publishing House Shkenca, Tiranë, tetor 1998.
- 97 Teorikisht ekzistojnë disa opsione: Do të "shkrihen" të dy shtetet dhe do të krijohet një i vetëm; do të ruajnë të dy shtetet sovranitetin e tyre duke u bashkuar në një konfederatë, apo në një sistem federativ. Në cilindo opsion, bashkimi është shumë më shumë se sa thjesht bashkimi i territoreve.
- 98 Intervistë me Ilir Kalemaj, gusht 2019.
- 99 "Ky 100 vjetor na fton, na frymëzon të vazhdojmë për të bërë realitet ëndrrën e atyre që u flijuan gjatë një shekulli për liri dhe dinjtet kombëtar. Ajo ëndërr në të vërtetë 1000 herë po ta lexosh, është ëndrra e bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Këtu nga Shkupi dua t'ju bëj thirrje shqiptarëve. Të punojnë çdo minutë, çdo orë, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, çdo vit për bashkimin e tyre. U bëj thirrje fqinjëve tanë, përpiguni të kuptoni drejt bashkimin e shqiptarëve do të bëheni më të lirë, më të drejtë dhe shqiptarët janë të gatshme për një bashkëpunim miqësor, afatgjatë, shekullor. Shqiptarët e lirë do të jenë forcë kryesore zhvillimi për veten e tyre dhe rajoni", Shiko fjalimin e Sali Berisha në Gazeta Panorama: <http://www.panorama.com.al/shkup-mijera-ne-feste-per-100-vjetorin/>
- 100 Reuters, 'Greece, Macedonia take offence at Albanian rhetoric' EurActiv, 30.11.2012 <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/greece-macedonia-take-of-fence-at-albanian-rhetoric/>
- 101 Janjevic, Darko. 'Albania's Edi Rama floats joint president idea in Kosovo' Deutsche Welle, 2018. <https://www.dw.com/en/albanias-edi-rama-floats-joint-president-idea-in-kosovo/a-42642058>
- 102 Po aty.
- 103 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë <http://president.al/ep-content/uploads/2018/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>
- 104 Peci, Lulzim. 2020. Deconstruction of the idea of Unification. Pristina: KIPRED, 2020.
- 105 Republika e Kosovës Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Dispozitat themelore, Neni 3. http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf
- 106 Peci, Lulzim. 2020. Deconstruction of the idea of Unification. Pristina: KIPRED, 2020.
- 107 Platforma e Akademisë së Shkencave e vitit 1998 u konsiderua si një provë për përpjekjet e Shqipërisë për një Shqipëri të Madhe edhe nga ata që e kishin lexuar, edhe nga ata që thjesht nuk dëshironin ta lexonin.
- 108 Platform for the Solution of National Albanian Question. f. 41
- 109 Kosova është edhe më e limituar kur është fjala për sovranitetin në punët e jashtme, edhe për faktin se 5 anëtarë të BE, si dhe dy anëtarë të Këshillit të Sigurimit ende nuk

e kanë njohur.

- 110 Intervistë me Aldo Bumçin, tetor 2019.
- 111 Sipas sondazhit të IDRA, bashkimin kombëtar nuk do e pranojnë shtetet e tjera, do ketë konflikte me shtetet fqinje, me fuqitë e tjera botërore.
- 112 Kundërshtimi potencial i Serbisë identifikohet si një nga pengesat kryesore të një bashkimi të mundshëm për të intervistuarit në Shqipëri.
- 113 Fokus grup, cituar në Kosovë-Shqipëri: Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi (Prishtinë: KFOS, janar 2019)
- 114 Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.
- 115 Rakipi, Albert. 2018. “Bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë mund të prodhojë një shtet të dobët” Panorama
- 116 Intervistë me Aldo Bumçin, tetor 2019.
- 117 Studimi i IDRA
- 118 Udhëheqësit e Lëvizjes Vetëvendosja në Kosovë, përfshirë kryetarin Kurti, për të cilët kjo tezë ishte qendrore në narrativin e tyre politik, kanë filluar të flasin domosdoshmërinë e ndërtimeve dhe funksionimit të shtetshmërisë brenda përbrenda secilit shtet.
- 119 Intervistë me Tonin Gjuraj, shtator 2019.
- 120 Journal of Turkish Weekly. 2016 Intervistë me Albert Rakipin: “Albania and Albanians in the Balkans: Great expectations and disappointments” <http://www.turkishweekly.net/2016/05/13/news/albania-and-albanians-in-the-balkans-great-expectations-and-disappointments/>
- 121 Fokus grup, cituar në Kosovë-Shqipëri: Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi (Prishtinë: KFOS, Janar 2019)
- 122 Peci, Lulzim. 2020. “Kosovo and Albania – Deconstruction of the Idea of Unification” on Tirana Observatory: <https://tiranaobservatory.com/2020/04/06/kosovo-and-albania-deconstruction-of-the-idea-of-unification/>
- 123 Peci, Po aty.
- 124 Adomeit, Hannes. 2006. Gorbachev’s Consent Unified Germany’s membership in NATO. Paris: Working Paper, Paris Stiftung Wissenschaft und Politik, 2006.
- 125 Në fakt, një shtet më i madh, nga pikëpamja e territorit dhe e popullsisë, fuqisë ushtarake dhe ekonomike është një nga argumentet themelore të nacionalistëve/populistëve shqiptarë veçanërisht në ekuacionin e balancave të pushtetit me Serbinë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- 126 Adomeit, Hannes. 2006. Gorbachev’s Consent Unified Germany’s membership in NATO. Paris: Working Paper, Paris Stiftung Wissenschaft und Politik, 2006.
- 127 Këshilli Europian më 25 Mars 2020 vendosi hapjen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Sipas këtij vendimi Shqipëria do të mundë të

fillojë bisedimet sapo te jenë plotësuar një paketë prej 15 kushtesh. Shiko Ruettershof, Tobias. *The Opening of Accession Negotiations: A new Hope for Albania* Tirana Observatory Vol. 2, Nr.2, AHS Tirana 2020

- 128 'Shteti i fortë' përcaktohet këtu jo nga pikëpamja ushtarake, por në pikëpamjet e kapaciteteve për të siguruar për qytetarët të mirat publike bazë: sigurinë, drejtësinë, shanset e barabarta, arsimin, shërbimin shëndetësor, etj.
- 129 Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.
- 130 Fischer, Bernd J. *Albania 1933-1945: A view through Western Documents*. Tirana: AHS, 2012.
- 131 Gurakuqi, Romeo. 2018. *Shqipëria dhe tokat e lirume, 1939-1946*. Tiranë: Botimet Jozef, 2018
- 132 Basha, Ali. 2012. *Islami në Shqipëri gjatë shekujve*. Tirana: 2012
- 133 Pothuajse paralelisht opozita politike dhe qeveritë respektive në Shqipëri ju drejtuan Komisionit të Venecias për zgjidhur konfliktet e brendshme politike. Dy ishin rastet më ekstreme: në Shqipëri shumica socialiste në parlament iu drejtua Komisionit të Venecias për të kërkuar legjitimitetin e proceduarave për shkarkimin e Presidentit të Republikës, ndërsa vetëm pas disa muajsh, Kryeministri i Kosovës iu drejtua po Komisionit të Venecias për të kundërshtuar dekretin e Presidentit të Republikës për dhënien e mandatit të Kryeministrit një kandidati të ri.
- 134 Posen, Barry R. 1993. 'The security dilemma and ethnic conflict' on Survival, no. 35:127-147 (1993) DOI: 10.1080/00396339308442672
- 135 Intervistë me Remzi Lanin, shtator 2019.

Kapitulli IV

PËRFUNDIME

Shqipëria dhe Kosova aktualisht po zhvillojnë marrëdhëniet e tyre si dy shtete të pavarura. Përgjatë një trajektoreje historike, që fillon me tërheqjen e Perandorisë Otomane nga Ballkani dhe krijimin e shteteve të pavarura, Shqipëria dhe Kosova kanë funksionuar si dy shoqëri, ekonomi dhe tregje të ndara me një mungesë pothuajse të plotë të bashkëpunimit dhe ndërvarësisë me njëra tjetrën.

Nga pikëpamja strategjike, Shqipëria dhe Kosova e shikojnë të ardhmen e tyre të përbashkët si anëtare të Bashkimit Europian. Megjithëkëtë gjatë pesë gjashtë vjetëve të fundit gjithmonë e më shumë duket se është e pranishme ideja e *bashkimit*. Pavarësisht motiveve, paqartësisë apo mbështetjes reale që aktualisht ka teza e bashkimit si një opsion për një të ardhme të përbash-

kët, kjo tezë ka rikthyer debatet rreth çështjes kombëtare shqiptare dhe zgjidhjen e plotë të saj përmes *bashkimit kombëtar*.

Kur është fjala për bashkimin kombëtar, Kosova, për arsye politike, historike, gjeografike, kulturore dhe ekonomike, është qendrore. Kosova ishte djepi i nacionalizmit shqiptar. Lëvizja Kombëtare Shqiptare për pavarësi filloi në Kosovë me Lidhjen e Prizrenit. Identifikimi i çështjes kombëtare kryesisht me Kosovën është i dukshëm në të gjithë trajektoren historike të shtetit shqiptar, pavarësisht nga regjimet e ndryshme që kanë qeverisur gjatë më shumë se njëqind vjetëve të fundit.

Domosdoshmëria e *bashkimit kombëtar*, komponenti kryesor i të cilit është bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, ka qenë dhe vijon të mbështetet në dy argumente: Së pari, argumenti historik, sipas të cilit *bashkimi kombëtar* është zgjidhja e një padrejtësie historike, sepse shqiptarët e konsideronin një padrejtësi vendimin e Fuqive të Europës për njohjen e shtetit duke lënë jashtë këtyre kufijve shtetërorë gjysmën e territoreve.

Së dyti, *bashkimi kombëtar* është një kusht themelor (*a sine qua non*) për të pasur një shtet funksional e të qëndrueshëm.

Kohët e fundit ka filluar të artikulohet një argument i ri për domosdoshmërinë e bashkimit kombëtar dhe posaçërisht për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Sipas këtij argumenti në rast se “Europa mbyll dyert për Shqipërinë dhe Kosovën,” atëherë zgjidhja mbetet bashkimi mbarëkombëtar, që nënkupton së pari bashkimin e Shqipërisë me Kosovën.

Në një rrafsh teorik, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë është shpjeguar dhe argumentuar si bashkimi i një pjese të kombit

dhe të territorit me shtetin amë, ku *pjesa* është Kosova dhe *shteti amë* Shqipëria. Gjatë një trajektoreje që zë fill nga themelimi dhe njohja ndërkombëtare e një shteti shqiptar (Shqipërisë) dhe deri në shpalljen dhe njohjen ndërkombëtare të Kosovës si shtet i pavarur, më 2008, Shqipëria nuk e ka luajtur asnjëherë rolin e *shteti amë* kundrejt Kosovës.

Në mbarim të Luftës të Parë Botërore, në Konferencën e Paqes, Shqipëria shpëtoi një nga një copëtim i ri i territoreve që i ishin njohur qysh më 1913. Në rrethana të tilla, ishte krejtësisht e pamundur që Shqipëria të ndërmernte ndonjë hap për të kërkuar që Kosova apo territore të tjera në Ballkan t'i bashkoheshin shtetit të saj.

Gjatë qeverisjes së Mbretit Zog, për herë të parë në marrëdhëniet Shqipëri Kosovë fillon të shfaqet një faktor tjetër influencues: marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe me Serbinë pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Ky faktor do të shndërrohet më pas në një karakteristikë thuajse permanente të politikës së jashtme të Shqipërisë, siç është dëshmuar *gjatë muajit të mjaltit* Shqipëri Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë Luftës së Ftohtë apo me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet nëntëdhjetë.

Gjatë Luftës së Ftohtë, Shqipëria komuniste ishte shumë e dobët për t'u kujdesur për Kosovën apo ish-territoret e tjera nën Jugosllavi. Në rrethanat kur ishte thjesht një shtet klient i Jugosllavisë, nuk kishte gjasa që Shqipëria të kërkonte “rikthimin” e Kosovës. Edhe “prishja” e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe afrimi i Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, një nga dy fuqitë botërore, nuk solli asnjë ndryshim në politikën e jashtme të

Shqipërisë në përgjithësi dhe në marrëdhëniet me Kosovën në veçanti.

Shqipëria doli nga komunizmi me një shtet shumë të dobët, nëse jo të dështuar, me një ekonomi të falimentuar, ndërsa nuk mund të flitej për kapacitetet ushtarake, me gjithë militarizimin e ekonomisë dhe të shoqërisë shqiptare. Shqipëria, më 1990, e kishte krejtësisht të pamundur të hynte në luftë për Kosovën, kur edhe për mbrojtjen dhe sigurinë e saj nuk mund të mbështetej në kapacitetet e veta njerëzore, ushtarake apo ekonomike.

Gjatë pothuaj tri dekadave, qysh nga rënia e komunizmit, Shqipëria nuk ka shfaqur ambicie për ta parë të ardhmen e Kosovës si pjesë të territorit të saj.

Aktualisht një anëtare e NATO-s dhe një vend kandidat për anëtar i BE-së, Shqipëria nuk është në gjendje të demonstrojë pavarësi në punët e jashtme apo aq më pak të jetë sovrane, sidomos kur është fjala për marrëdhëniet me Kosovën apo ish-territore të Shqipërisë otomane në Ballkan, të cilat prej vitit 1913 kanë qenë dhe vijojnë të jenë pjesë e territoreve të shteteve të njohura ndërkombëtarisht si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Republika e Kosovës prej vitit 2008.

Në dy prej momenteve kyçe për të ardhmen e Kosovës, më 1991, kur u pa qartë se Jugosllavia po shkonte drejt shpërbërjes dhe më 1997-1998, kur shpërtheu lufta në Kosovë, Shqipëria përjetonte krizat më të rënda të historisë së saj moderne. Prej vitit 1991, kur gjendej në kufijtë e mbijetesës, Shqipëria e shikonte të ardhmen e Kosovës në *krijimin e hapësirave demokratike* në Jugosllavi, praktikisht pa mbështetur asnjë nga opsionet

e formuluar nga udhëheqësit politikë të Kosovës. Ndërsa më 1997- 1998, kur *de facto* pothuajse kishte pushuar së ekzistuari si një shtet, duke humbur edhe kontrollin mbi territorin dhe kufijtë e vet, Shqipëria e mbështeste respektimin e pakicave shqiptare në Jugosllavinë e mbetur, duke pranuar kështu se Kosova ishte një çështje e brendshme e Serbisë.

Pas tri dekadash të rënies së komunizmit në Shqipëri dhe një dekade të pavarësisë së Kosovës, ideja e bashkimit të Shqipërisë me Kosovën dhe ideja e bashkimit kombëtar është kthyer sërish. Kjo ide është e pranishme në narrativët populiste/nacionaliste të elitës politike në të dy shtetet, por shfaqet mjaft populllore edhe në perceptimin që publiku edhe në Kosovë edhe në Shqipëri ka për *bashkimin*. Aktualisht 74 për qind e qytetarëve shqiptarë do të votonin pro bashkimit të Shqipërisë me Kosovën në një referendum të mundshëm.

Megjithëkëtë do të ishte naive të nxirrje përfundime vetëm duke u nisur nga kjo shifër, pra, që 74 për qind e qytetarëve shqiptarë mbështesin idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë . Nëse çështja e bashkimit do të ishte kaq populllore dhe kaq e rëndësishme për qytetarët shqiptarë, atëherë si shpjegohet që kjo çështje mungon në programet politike të partive politike shqiptare dhe në fushatat e tyre elektorale. Marrëdhëniet me Kosovën dhe aq më pak çështja e bashkimit nuk futet as në dhjetë problemet, për të cilat qytetarët shqiptarë mendojnë se janë të rëndësishme dhe preokupojnë jetën e tyre.

Aktualisht, shqiptarët në të dyja anët e kufirit nuk kanë një ide të qartë se çfarë bashkimi dëshirojmë dhe si duhet të arrihet ky bashkim.

Duhet të bashkohet Kosova me Shqipërinë, ku Shqipëria anekson Kosovën me pëlqimin e kësaj të fundit dhe shteti që krijohet është një Shqipëri e zmadhuar me territorin dhe popullsinë e Kosovës? A do e pranonin humbjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës 64 për qind e qytetarëve të saj, që aktualisht mbështesin bashkimin? Do të bashkohen të dy shtetet në një shtet të vetëm dhe do të krijojnë një konfederate apo një shtet të vetëm, unitar? Opsioni i fundit, por ndoshta më pak i mundshëm për të ndodhur është ky: Shqipëria do të bashkohet me Kosovën dhe kjo e fundit anekson territorin dhe popullsinë e Shqipërisë, duke krijuar një Kosovë më të madhe se sa ajo aktualja? A do ta pranonin këtë opsion 75 për qind e qytetarëve të Shqipërisë që mbështesin bashkimin?

Më shumë se njëqind vjet më parë, bashkimi arsyetohej me argumentin e korigjimit të padrejtësisë historike që Fuqitë e Mëdha bënë kombit shqiptar duke i copëtuar territoret e tij, por edhe me argumentin e funksionimit dhe qëndrueshmërisë së shtetit: Shqipëria nuk mund të ishte një shtet funksional dhe i qëndrueshëm pa Kosovën dhe territore të tjera. Mirëpo në rrethanat e sotme është e vështirë të shpjegosh dhe arsyetosh se Shqipëria është një shtet i dobët, nëse jo i dështuar, me argumentin se nuk është realizuar bashkimi kombëtar, se trojet shqiptare janë të copëtuara dhe Kosova nuk është e bashkuar me Shqipërinë.

Udhëheqësit politikë, të paktën në rastin e Shqipërisë, e propagandojnë idenë e bashkimit të Shqipërisë apo idenë e bashkimit kombëtar edhe si një alternativë ndaj integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Mirëpo një shumicë dërmuese ose 84,7 për qind e qytetarëve shqiptarë në Republikën

e Shqipërisë, por, në fakt, edhe në Republikën e Kosovës, 66,4 për qind e popullsisë, midis variantit të integritit evropian të shtetit të tyre dhe variantit të bashkimit, zgjedhin të parin.

Ka shumë mundësi, që më shumë se sa një alternativë ndaj procesit të integritit evropian të Shqipërisë, tezën e bashkimit të Shqipërisë me Kosovën, pra, kartën nacionaliste, Qeveria Shqiptare e përdor për t'i bërë presion Brukselit, nëse jo shantazh, për të inkurajuar procesin shumë të ngadaltë të integritit evropian .

Qysh prej vitit 2008, ndonëse reflektojnë një tendencë rritjeje, marrëdhëniet midis dy shteteve mbeten përgjithësisht të varfra. Por më i rëndësishëm është fakti se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës nuk janë të çliruara nga tensionet, të cilat hera herës shoqërohen nga polemika të ashpra. Tensionet në rritje dhe mosmarrëveshjet serioze burojnë nga një qasje paternaliste e Tiranës ndaj Prishtinës. Por një burim tjetër i tensioneve politike dhe i lidhur me burimin e parë janë edhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Serbinë, si edhe përfshirja e Kosovës dhe e çështjeve të saj në këto marrëdhënie.

Ndërsa flet gjithmonë e më shumë për *bashkimin*, Shqipëria aplikon një qasje paternaliste ndaj Kosovës, madje hera herës duket sikur Shqipëria e konsideron Kosovën si një krahinë autonome të vetën. Kjo qasje paternaliste e Shqipërisë, që “*harron*” se Kosova është një shtet i pavarur, ka bërë që nga agjenda normale bilaterale e të dy shteteve të bjerrin çështjet normale të bashkëpunimit politik, bashkëpunimit ekonomik, shkëmbimet tregtare, bashkëpunimit kulturor, shkencor, akademik etj, Ndërtimi i një agjende strategjike midis Shqipërisë dhe Kosovës

kërkon pikë së pari që Shqipëria të heqë dorë nga qasja dhe akcionet paternaliste ndaj Kosovës dhe nga përdorimi *proxy* që udhëheqësit politikë në Shqipëri i bëjnë Kosovës për interesa afatshkurtra politike.

Pakënaqësia dhe tensionet në nivelin politik kanë të bëjnë shumë me faktin se edhe Serbia, por në mënyrë paradoksale, edhe Shqipëria, vijnë ta mbajnë Kosovën në agjendën e tyre bilaterale. Kosova nuk dëshiron që Shqipëria të flasë në emër të saj dhe nuk i njeh Tiranës ndonjë mandat që kjo e fundit të negociojë me Serbinë në emër të Kosovës. Po kështu, Kosova nuk dëshiron që Shqipëria të ketë një rol ndërmjetësues në marrëdhëniet e saj me Serbinë. Qeveria e Republikës së Kosovës duket se i shikon me rezerva përpjekjet e Shqipërisë për të udhëhequr procesin e pajtimit të shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan sipas modelit franko-gjerman. Sipas Qeverisë së Kosovës, pajtimi i shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan kalon përmes Prishtinës dhe jo përmes Tiranës. Ky është ekuacioni i paqes, i ngjashëm me ekuacionin e paqes Gjermani-Francë, të cilit i referohet shpesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

E rëndësishme dhe në shërbim të interesave afatshkurtra politike dhe të luftës politike të një pjese të elitave politike në Tiranë dhe në Prishtinë, qofshin këto në pushtet apo në opozitë, nuk është *bashkimi* i Shqipërisë me Kosovën, por *ideja* e bashkimit, e cila është shndërruar në një dogmë, të cilën askush nuk duhet ta vërë në pikëpyetje dhe rreth së cilës nuk duhen bërë pyetje.

Pavarësisht se pengesa ligjore, që mund të burojnë nga Kushtetuta e Shqipërisë apo e Drejta Ndërkombëtare, të cilat do

ta pengonin bashkimin e Shqipërisë me Kosovë, nuk ekzistojnë, ky bashkim nuk është i mundshëm pa pëlqimin e Komunitetit Ndërkombëtar dhe të Fuqive të Mëdha.

Shqipëria dhe Kosova, përveç që janë dy shtete të vogla, janë edhe shtete të dobëta, me një varësi kritike nga komuniteti ndërkombëtar. Pavarësia, sovraniteti dhe kapacitetet e Shqipërisë dhe të Kosovës ashtu sikundër i shumë shteteve të vogla dhe sidomos të dobëta për të operuar në mjedisin ndërkombëtar janë përgjithësisht të limituara. Edhe nga kjo perspektivë bashkimi i Shqipërisë me Kosovën nuk do të ishte i mundshëm pa miratimin e komunitetit ndërkombëtar.

Bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës në çfarëdo lloj forme do të çonte në ndryshimin e hartës politike të Ballkanit. Ndryshimet e mëparshme në hartën politike të Ballkanit, përfshirë edhe ato më të fundit, janë shoqëruar me konflikte të përgjakshme brenda shteteve dhe midis shteteve, si edhe me ndërhyrjen e fuqive të treta, Fuqive Europiane dhe SHBA-së.

Bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, në të gjitha skenarët teorikë, do të çonte në krijimin e një shteti pothuajse etnikisht të pastër dhe mund të inkurajonte krijimin e shteteve të pastra etnike që në Ballkan duket një mision i pamundur, por edhe konfliktet dhe dhuna do të ishin krejt të sigurta.

Në të gjithë skenarët e mundshëm, kur Shqipëria dhe Kosova bashkohen dhe krijojnë një entitet të ri, kur Kosova i bashkohet Shqipërisë (ose Shqipëria i bashkohet Kosovës) ose kur Shqipëria dhe Kosova bashkohen në një konfederatë, në të gjitha rastet entiteti i ri do të ketë nevojë për njohje ndërkombëtare. Pa pëlqimin e Komunitetit Ndërkombëtar për bashkimin, procesi

i njohjes ndërkombëtare do të jetë shumë i vështirë, i gjatë dhe në asnjë rast i garantuar. Kjo do ta ndërlikonte funksionalitetin e brendshëm të shtetit dhe ndoshta do të vinte në pikëpyetje vetë ekzistencën e tij.

Do të ishte shumë e dyshimtë në mos krejtësisht e pamundur, që entiteti i ri, i cili vjen nga bashkimi të trashëgonte marrëveshjet edhe anëtarësinë që të dy shtetet gëzojnë aktualisht në organizata dhe institucione ndërkombëtare. Në rastin e krijimit të një entiteti të ri (shtet i ri apo konfederatë) është krejtësisht e qartë se anëtarësia në NATO, që Shqipëria aktualisht ka ose statusi i vendit kandidat i Shqipërisë kundrejt BE-së, janë të pashmërgueshme.

Por gjithashtu është pak e besueshme që në rastin kur Kosova bashkohet me Shqipërinë, kjo e fundit të ruajë anëtarësimin në Aleancë apo statusin që ka në BE. Në skenarin kur Shqipëria do të ishte e gatshme të dorëzonte pavarësinë dhe sovranitetin e saj duke u bashkuar me Kosovën, në favor të një Kosove më të madhe, gjërat do të ndërlikoheshin së tepërmi, nëse mbajmë parasysh se Kosova aktualisht, nuk ka njohje të plotë ndërkombëtare, nuk e njohin disa prej anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nuk është anëtare e OKB, nuk e njohin pesë vende anëtare të BE-së, si dhe ende nuk ka anëtarësim në një sërë organizatash dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Në rast të një bashkimi eventual, në çfarëdo forme të mundshme, Shqipëria do të vinte në pikëpyetje edhe anëtarësinë e saj në OKB, OSBE, Këshillin e Europës dhe institucione e organizata të tjera ndërkombëtare.

Megjithëse një nga dy argumentet themelore dhe historike

të domosdoshmërisë së bashkimit të Shqipërisë me Kosovën është çështja e funksionalitetit të shtetit, ka mundësi që bashkimi i të dy shteteve, tipari themelor i të cilëve është mosfunksionimi, të prodhonte një shtet edhe më të dobët, me një shkallë funksionaliteti edhe më të ulët, nëse nuk mund të çonte në një shtet të dështuar.

Po ashtu, nuk është e pamundur që bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, në të gjitha e format e mundshme, të çonte në krijimin e një shteti që do të ishte i lirë dhe imun nga konfliktet politike, social-ekonomike, urbane, fetare, kulturore dhe zhvillimore?

Nga pikëpamja teorike, bashkimi i Shqipërisë me Kosovën në një shtet të vetëm do të krijonte kushtet për atë që Barry Posen e përkufizon si *the emerging anarchy*, që nuk do të vijë nga rënia e një *imperial order*, siç ka qenë rasti i rënies së Bashkimit Sovjetik apo Federatës Jugosllave, por nga rënia e rendit shtetëror në të dy vendet, për të shkuar drejt një rendi të ri, që vjen nga bashkimi.

Ashtu sikundër grupe etnike, që përfaqësojnë kombe të ndryshme, që dikur kishin jetuar në paqe nën *rendin perandorak*, vihen përballë dilemës së sigurisë kur ky rend perandorak bie, në mënyrë të ngjashme edhe komunitete të krijuara nga ideologji të ndryshme, politike apo doktrina të ndryshme fetare, faktorë ekonomikë, kulturorë, urbanë apo gjeografikë, gjithashtu mund të vihen përballë një dileme të sigurisë dhe mund të përfundojnë në konflikte dhe dhunë për të mbajtur ose për të avancuar statuset e tyre në kushtet e reja të bashkimit të Shqipërisë dhe Kosovës në një shtet të vetëm.

Bibliografi

Libra

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. *Platforma për Zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare*. Tiranë: 1998.

Albania in the next ten years - envisioning the future. Tirana: Albanian Institute for International Studies AIIS, 2012.

Albania Twenty Years After, People on state and democracy. Tirana: Albanian Institute for International Studies AIIS, 2010

Basha, Ali. *Islami në Shqipëri gjatë shekujve*. Tirana: 2012

Biberaj, Elez. *Çështja Kombëtare Shqiptare*. Tirana: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, 2014.

Biberaj, Elez. *The Albanian National Question*. New York: New York Council of Foreign Relations Pres, 2000.

Çela, Alba and Geron Kamberi, *Rinia Shqiptare 2018/2019*. Tirana: Friedrich Ebert Stiftung, 2019

- Demi, Agron dhe Blendi Ceka. 2019. “*Kosovo-Albania Interaction, Knowledge, values, beliefs, cooperation and unification.*” Kosova Foundation for Open Society, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë 2019, f. 12.
- Fischer, Bernd J. *Albania 1933-1945: A view through Western Documents.* Tirana: AIIS, 2012
- Fischer, Bernd J. *Albania at War, 1939-1945.* London: Hurst & Company, 1999.
- Fischer, Bernd. *King Zog and the struggle for stability in Albania.* Tirana: AIIS, 2015.
- Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe tokat e lirueme 1939-1946.* Tiranë: Botimet Jozef, 2018.
- Heaton-Armstrong, D. *Prince Wied: The six months Kingdom.* Tirana: Albanian Institute for International Studies, 2012.
- Hulumtimi cilësor mbi perceptimet dhe vlerësimet e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë.* Raporti Përmbledhës. Tiranë: i pabotuar, 2018.
- Krisafi, Ledion. *Shqipëria dhe Jugosllavia: Mitet, faktet dhe dyshimet (1945-1948)* Tiranë: Naimi, 2017.
- Malcolm, Noel. *Kosovo a Short History.* Pan Books, 1998.
- Pano, Nicholas C. *The Peoples’s Republic of Albania.* New York: John Hopkins Press. 1968.
- Peci, Lulzim. *Deconstruction of the idea of Unification.* Pristina: KIPRED, 2020.
- Pollo, Stefanaq and Arben Puto. *The History of Albania, from its origin to the present day.* London, Boston and Henley: Routledge and Kenan Paul, 1981.

Rethinking Albania's Foreign and Regional Policy. Tirana:
Albanian Institute for International Studies AIIS, 2018.

Skëndi, Stavro. *The Albanian National Awakening, 1878–1912*. Princeton: 1967.

Syla, Sabit. *Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*,
Instituti i Historisë Prishtinë. Prishtinë, 2012.

Woodall, Robert Larry. *The Albanian problem at Paris Peace Conference*. Tirana: AIIS, 2019.

Periodikë

“Bashkim Kombëtar deri në 2025-ën: Rama shpalos projektin Kosovë-Shqipëri” Mapo. 2018. Aksesuar më 20/05/2020 <https://gazetamapo.al/bashkim-kombetar-deri-ne-2025-en-rama-shpalos-projektin-kosove-shqiperi/>

“Edi Rama paralajmëron bashkimin e Kosovës me Shqipërinë!” Zeri. 2019. Aksesuar më: 20/05/2020 <https://zeri.info/aktuale/235135/edi-rama-paralajmëron-bashkimin-e-kosoves-me-shqiperine/>

“For Europe, geopolitics starts at home.” The Economist. 2020. Aksesuar më: 18/01/2020

“Albania and Albanians in the Balkans: Great expectations and disappointments” Journal of Turkish Weekly, 2016
Aksesuar më: 20/05/2020: <http://www.turkishweekly.net/2016/05/13/news/albania-and-albanians-in-the-balkans-great-expectations-and-disappointments/>

“Albania–Kosovo Relations: the show goes on”, Tirana Times, 2019. Aksesuar më: 20/05/2020: <http://www.tiranatimes.com/?p=142612>

“Aleanca Kuq e Zi, Spahiu: Shqipëria e Kosova të bashkohen.”
Bota Sot, 2012.

“Edi Rama: Kosova dhe Shqipëria do ta kenë një president të përbashkët të Unitetit Kombëtar.” *Bota Sot*. 2018. Aksesuar më: 18/02/2018 <https://www.botasot.info/lajme/837341/edi-rama-kosova-dhe-shqiperia-do-ta-kene-nje-president-te-perbashket-te-unitetit-kombetar/>

“Luftë tregtare mes vëllezërish, Kosova kërcënon me takse Shqipërinë” *Gazeta Shqip*, 2019. Aksesuar më: 20/03/2020 <https://www.gazeta-shqip.com/2019/06/27/lufte-tregtare-mes-vellezerish-kosova-kercenon-me-takse-shqiperine/>

“Serbia me tre fytyra, Shqipëria e Kosova me një fytyrë, kuq e zi” *Time.al*. 2018. Aksesuar më: 20/05/2020 <http://time.ikub.al/18-11-26-Fjalimi-kuq-e-zi-i-kryeministrit-te-Shqiperise-ne-mbledhjen-e-dy-Qeverive703980/Serbia-me-tre-fytyra-Shqiperia-e-Kosova-me-nje-fytyre-kuq-e-zi.aspx>

Adomeit, Hannes. “Gorbachev’s Consent Unified Germany’s membership in NATO”. Paris: Working Paper, Paris Stiftung Wissenschaft und Politik, 2006.

Berisha, Sali. “Demokracia dhe Humanizmi - binom i pandarë.” Tiranë: Gazeta Shqiptare, 2010.

Demjaha, Agon. “Balkan Mini-Schengen: A Well Thought Regional Initiative or a Political Stunt?” Tirana Onservatory, 2020.

Goro, Robert. “FYROM: Supremacia e inferioritetit” *Kurier*, 2001.

<https://www.economist.com/europe/2020/01/18/for-europe-geopolitics-starts-at-home>

Janjevic, Darko. “Albania’s Edi Rama floats joint president idea in Kosovo”. Deutsche Welle, 2018. Aksesuar më: 20/05/2020 <https://www.dw.com/en/albanias-edi-rama-floats-joint-president-idea-in-kosovo/a-42642058>

Judah, Tim. “Yugoslavia is dead: long live the Yugosphere good news from the Western Balkans.” Papers on South Eastern Europe, Economides, Spyros and Kovanovic, Ivan (eds.) LSEE - Research on South Eastern Europe, London, UK, 2009.

Kalemaj, Ilir. “Albania and Kosovo Present and Future” Tirana Observatory, 2020

Krasniqi, Ekrem and Retman Andrew. “US still open to Kosovo-Serbia land swap”. EU Observer, 2020 at <https://euobserver.com/enlargement/147484>

Peci, Lulzim. “Kosovo and Albania – Deconstruction of the Idea of Unification”. Tirana Observatory: 2020. <https://tiranaobservatory.com/2020/04/06/kosovo-and-albania-deconstruction-of-the-idea-of-unification/>

Rakipi, Albert. “Albania and Kosova - The Centrality Of Economics”. Tirana Times, 2015.

Rakipi, Albert. “Albania-Serbia Relations, From enthusiasm to Status quo, From status quo to false promise of a strategic agenda”. Tirana Observatory, 2020.

Rakipi, Albert. “Bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë mund të prodhojë një shtet të dobët” Panorama, 2018.

Rakipi, Albert. “Il Piemonte Albanese è Bruxelles” Limes,

Revista Italiana di Geopolitica, Nr 2, 2008.

Rakipi, Albert. “Shqipëria dhe Kosova: Nga Lufta e Ftohtë të një agjendë strategjike, Europa vol. 7 Nr.1, Tirana, 2020. Aksesuar më: 20/05/2020 <http://europa.com.al/index.php/2020/02/24/shqiperia-dhe-kosova-nga-lufta-e-ftohte-tek-nje-agjende-strategjike/>

Rakipi, Albert. ‘A new Rapprochement between Albania and Serbia: The implications for Kosovo’, Vienna National Defence Academy, 2019.

Reuters, Greece, Macedonia take offence at Albanian rhetoric” EurActiv, 2012 Aksesuar më: 20/05/2020: <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/greece-macedonia-take-offence-at-albanian-rhetoric/>

Ruettershof, Tobias. “The Opening of Accession Negotiations: A new Hope for Albania” Tirana Observatory Vol. 2, Nr.2. Tirana, AIIS, 2020

Saracini, Klotilda. “Kosove-Shqiperi-rritet-bashkepunimi-per-shtim-te-volumit-te-shkembimeve-permes-portit-te-Durre-sit,” ATA.gov.al, Aksesuar më: 24/01/2020 <https://ata.gov.al/2020/01/24/kosove-shqiperi-rritet-bashkepunimi-per-shtim-te-volumit-te-shkembimeve-permes-portit-te-durre-sit/>

Shehu, Bekim. “Heqja e kufirit Kosovë-Shqipëri bashkim apo lehtësim i procedurave?” Radio DW, 12/02/2019 Aksesuar më: 12/01/2020 <https://www.dw.com/sq/heqja-e-kufirit-kosov%C3%AB-shqip%C3%ABri-bashkim-apo-le-ht%C3%ABsim-i-procedurave/a-47059880>

Tanner, Marcus. “Correcting Kosovo’s Border Would Shake

Postwar Europe's Foundations” Balkan Insight, 2018.

Uebfaqe

Fevziu, Blendi. 2018. “A është qëllim bashkimi i Shqipërisë me Kosovën?” Opinion, TV Klan. 20/09/2018 <https://www.youtube.com/watch?v=13xJjodxUzA>

Manifesti i Partisë Socialiste të Shqipërisë: <https://www.ps.al/programi/manifest-2017-2021>

Programi politik i Partisë Demokratike: <https://pd.al/politika-e-jashtme/>

Platforma Politike e Lëvizjes Socialiste për Integrim: <http://www.lsi.al/platforma-politike/>

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Aksesuar më 12/10/2019 <http://president.al/wp-content/uploads/2018/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>

Intervista

Intervistë me Anton Berishën.

Intervistë me Albin Kurti, shtator 2019.

Intervistë me Aldo Bumçin, tetor 2019.

Intervistë me Arben Hajrullahun, gusht 2019.

Intervistë me Arjan Dyrmishin.

Intervistë me Enver Robellin.

Intervistë me Genc Rulin, shtator 2019.

Intervistë me Ilir Kalemaj.

Intervistë me Jakup Krasniqin.

Intervistë me Remzi Lanin, shtator 2019.

Intervistë me Tonin Gjuraj, shtator 2019.

Shtojca 1

Marrëveshjet e nënshkruara midis Shqipërisë dhe Kosovës 2000-2008

1. Marrëveshja Kosovë-Shqipëri për mënjanimin e tatimeve të dyfishta;
2. Memorandumi i Mirëkuptimit Kosovë-Shqipëri në fushat e Standardizimit dhe Akreditimit;
3. Marrëveshja Kosovë-Shqipëri për bashkëpunim në fushën e turizmit;
4. Marrëveshja Kosovë-Shqipëri për promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve;
5. Marrëveshja Kosovë-Shqipëri mbi bashkëpunimin në fushën e energjisë;
6. Marrëveshja Kosovë-Shqipëri në bashkëpunimin e shërbimeve publike veterinare;
7. Marrëveshja Kosovë-Shqipëri mbi bashkëpunimin për mbrojtjen e bimëve.

Marrëveshjet 2009-2013

8. Marrëveshje për udhëtim të ndërsjellë të qytetarëve së bashku me Protokollin përkatës për Lëvizje në zonat kufitare (e nënshkruar më 6 tetor 2009);
9. Marrëveshje për ripranimin e personave, së bashku me Protokollin e zbatimit të marrëveshjes (e nënshkruar më 6 tetor 2009);
10. Marrëveshje për bashkëpunim policor (e nënshkruar më 6 tetor 2009).
11. Marrëveshje për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet doganore (e nënshkruar më 6 tetor 2009);
12. Marrëveshja për Transportin Ndërkombëtar Rrugor për udhëtarët dhe mallrat (e nënshkruar më 22.07.2011);
13. Marrëveshje për të bashkuar shërbimet konsullore në disa prej përfaqësive të të dy vendeve në botë (e nënshkruar më 13 janar 2012);
14. Marrëveshja në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjen penale-ekstradim, transferim të personave të dënuar dhe ndihmë të ndërsjellë (e nënshkruar më 13 janar 2012);

Marrëveshjet e nënshkruara në takimin e parë të dy qeverive në Prizren, 11 janar 2014:

15. Dokumenti për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë;
16. Marrëveshja për bashkëpunim në lehtësimin e tregtisë;
17. Marrëveshja në fushat e transportit dhe infrastrukturës;
18. Propozimi për Bashkëfinancim të pajisjeve mjekësore të Maternitetit të Preshevës;
19. Propozimi për përfaqësimin e përbashkët konsullor midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë;
20. Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë;
21. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të energjisë;
22. Themelimi i iniciativës për Fondin Zhvillimor për Luginën e Preshevës;
23. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e kulturës dhe aktivitetet për ndërtimin e kalendarit të përbashkët kulturor;
24. Propozimi për bashkëfinancimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit DOKUFEST në Prizren;
25. Propozimi për heqjen e taksës së TVSH-së apo taksës tjetër doganore për importin e librit nga Shqipëria;
26. Dorëzimi i legjislacionit të BE-së të përkthyer në gjuhën Shqipe nga Ministria e Integrimit Evropian e Republikës së Shqipërisë te Ministria e Integrimit Evropian e Republikës së Kosovës;

27. Themelimi i Komisionit të Përbashkët Teknik për përkthimin e legjislacionit të BE-së, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit ndërmjet Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Kosovës;

**Marrëveshjet e nënshkruara në takimin e
dytë të dy qeverive në Tiranë, 23 mars 2015:**

28. Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë”;
29. Memorandum mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm;
30. Protokoll mbi shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit;
31. Protokoll për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare;
32. Memorandum i Mirëkuptimit për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrive të Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës;
33. Marrëveshje e Bashkëpunimit për organizimin e përbashkët të mësimit të Gjuhës Shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë;
34. Marrëveshje e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
35. Marrëveshje për bashkërendim institucional për përparimin dhe zhvillimin profesional të mësimeve në arsimin

parauniversitar;

36. Protokoll për zbatimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë;
37. Memorandum mbi bashkëpunimin në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
38. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet e nënshkruara në takimin e tretë të dy qeverive në Prishtinë, 3 qershor 2016:

39. Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të certifikatës së testim/kalibrimit të tahogرافit të mjeteve rrugore;
40. Marrëveshja për bashkëpunim në mes autoriteteve tatimore dhe doganore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e hetimeve administrative, hetimeve tatimore dhe doganore;
41. Marrëveshja për krijimin e Qendrës së Përbashkët Trajnuese;
42. Marrëveshja e bashkëpunimit për ngritjen e kapaciteteve në realizimin e reformave në fushën e mirëqeverisjes dhe administrimit publik;
43. Marrëveshja për partneritet për bashkëpunimin ndërkufitar;

44. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Mjedisit të Republikës së Shqipërisë;
45. Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë.

**Marrëveshjet e nënshkuara në takimin e
katërt të dy qeverive në Korçë, 27 nëntor 2017:**

46. Marrëveshje bashkëpunimi për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë;
47. Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e diasporës;
48. Marrëveshje bashkëpunimi për qendrat kulturore në Diasporë;
49. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme;
50. Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të anëtarësimit në BE;
51. Memorandum bashkëpunimi mes kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin për zbatimin e rregullimit më të mirë e të vlerësimit të ndikimit për përmirësimin e praktikave të zhvillimit të politikave;

52. Marrëveshje për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension;
53. Memorandum mirëkuptimi mes Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe Agjencisë për Investime dhe përkrahjen e sipërmarrjeve në Kosovë;
54. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Rinisë dhe Sporteve të Kosovës;
55. Protokoll për bashkëpunimin teknik në fushën e bujqësisë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës për njohjen bilaterale të njohjeve të certifikatave të veterinarë dhe produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore;
56. Memorandum bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
57. Memorandum mirëkuptimi në krijimin e bursës shqiptare të energjisë elektrike mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës.

Marrëveshjet e nënshkuara në takimin e pestë të dy qeverive në Pejë, 26 nëntor 2018:

58. Nënshkrimi i Marrëveshjes për heqjen e çmimeve të shërbimeve Roaming për rrjetet publike të komunikimeve të

lëvizshme ndërmjet ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

59. Nënshkrimi i Protokollit për Kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë-Vërmicë, në mes të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë.
60. Nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëpunimin në fushën e borxhit publik, financimeve të huaja dhe marrëdhëniet me institucionet Financiare Ndërkombëtare.
61. Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për pronësinë industriale të RKS dhe Drejtorisë së përgjithshme të pronësisë industriale të Republikës së Shqipërisë.
62. Nënshkrimi i Protokollit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, për njohjen bilaterale dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinarë dhe fito sanitare që do të shoqërojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produktet bimore gjatë importit, eksportit dhe transitit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
63. Nënshkrimi i Marrëveshjeve për bashkëpunim në fushën e Rinisë.
64. Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim, nxitjen e biznesit dhe të informimit të diasporës.

65. Nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen reciproke të patentë shoferëve.
66. Nënshkrimi i Projekt “marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, ndërmjet ministrisë shëndetësisë dhe mbrojtës sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rakipi, Albert

Shqipëria dhe Kosova: a është bashkimi
e ardhmja e përbashkët? / Albert Rakipi;

red. Ledion Krisafi. - Tiranë: AIIIS, 2020

85 f. ; 16x23.5 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-195-30-2

1.Çështja shqiptare 2.Historia

3.Shqipëria 4.Kosova

323.1(=18)

94(=18)